

RAPORT

I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Për Programin e studimit MP ne “Menaxhim Bankar dhe Financiar” te

Universitetit Privat “Albania University”

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Prof.Dr. Drini SALKO

Prof.Asoc.Ermela KRIPA



Qershor 2019

HYRJE

Të dhëna për programin e studimit MP në “Menaxhim Bankar dhe Financiar”

Albanian University (AU) si një institucion privat, i Arsimit të Lartë, licencuar në prill të vitit 2004, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë.

Programi i parë i hapur në AU në fushën e ekonomisë, është licencuar me UMASH, Nr. 8981, datë 27.12.2005, Bachelor në “Financë-Bankë”.

Programi i studimit Master Profesional në ‘Menaxhim Bankar dhe Financiar’ zhvillohet nga Departamenti i Shkencave Ekonomike, pjesë e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike.

Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike është krijuar në vitin 2015 nga bashkimi i Fakultetit të Ekonomisë me Fakultetin e Arkitekturës dhe Inxhinierive me vendim të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë Nr. 117, datë 18.12.2015 dhe Urdhër të Ministrit Nr. 52, datë 05.02.2016.

Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike ofron tetë programe studimi të nivelit Bachelor, katër programe studimi të nivelit Master Profesional dhe katër programe studimi të nivelit Master i Shkencave.

Departamenti i Shkencave Ekonomike është njësi bazë akademike që zhvillon procesin e mësimdhënies dhe kërkimin shkencor në fusha të lidhura me profilet ekonomike e financiare të njohura dhe licencuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

Departamenti ofron dy programe studimi të ciklit të parë (Bachelor në ‘Financë-Bankë’ dhe Bachelor në ‘Menaxhim Biznesi’), katër programe studimi të ciklit të dytë (Master Profesional në ‘Administrim Biznesi’, Master Profesional në ‘Menaxhim Bankar dhe Financiar’, Master i Shkencave në ‘Administrim Biznesi’ dhe Master i Shkencave në ‘Menaxhim Bankar’).

Programi MP në ‘Menaxhim Bankar dhe Financiar’ është vlerësuar me Vendim të Këshillit të Akreditimit nr. 300, datë 13.01.2012 dhe licencuar me Urdhër të MASH Nr.176, datë 26.04.2012; është akredituar për herë të parë me kusht me Vendim të KA nr.181, datë 07.07.2016 dhe me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr. 441, datë 25.08.2016. Pas plotësimit të kushteve nga AU, programi kaloi sërisht procesin e vlerësimit të jashtëm nga ekspertët për shkallën e plotësimit të kushteve, proces i cili u finalizua me Vendim të Bordit të Akreditimit nr.53, datë 10.07.2017 me disa rekomandime për të cilat institucioni kishte detyrim të raportonte brenda vitit akademik 2017-2018. Pas plotësimit të rekomandimeve AU kërkoi rishikimin e vendimit nr. 53, pasi pika 2 shprehej “*Institucioni të mos pranojë te regjistrojë studentë të rinj në këtë program studimi deri në riorganizimin e tij, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi*”, procedurë e cila nuk u realizua për shkak të mungesës së akteve nënligjore përkatëse. Bordi i Akreditimit e konsideroi kërkesën e institucionit dhe rishikoi vendimin nr. 53 duke nxjerrë vendimin nr. 53/1, datë 15.12.2017. Ky vendim u shfuqizua me vendimin e Bordit të Akreditimit nr. 53/2, datë 02.02.2018, i cili është edhe vendimi në fuqi për programin.

AU mori masat dhe riorganizoi programin në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe rekomandimet e Bordit të Akreditimit . Ky proces u miratua nga MASR me shkresë nr. 6313/2 Prot. datë 18.07.2018 dhe në vitin akademik 2018-2019 u implementua programi i riorganizuar me 60 kredite ECTS.

Këtë vit programi i nënshtrohet akreditimit periodik për brezin 2018-2019, i cili është brezi i parë i programit të riorganizuar në 60 kredite ECTS.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

Prof.Dr.Drini SALKO

Prof.Asoc.Dr.Ermela KRIPA



Koordinatorë Teknike e kësaj procedure është specialistja e ASCAL znj. Renata QATIPI.

Më datë 03.06.2019, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare me Nr. 9/12 Prot., datë 03.06.2019 “Njoftim për dërgimin e Draft-Raportit të Vlerësimit të Jashtëm”, AU është njohur me Draft-Raportin e vlerësimit të jashtëm të programit të studimit MP në “Menaxhim Bankar dhe Financiar”.

Më datë 10.06.2019, AU përcjell zyrtarisht përgjigjen për Draft-Raportin, me shkresë Nr. 348/1 Prot., datë 10.06.2019, “Kthim përgjigje shkresës Nr. 9/12 Prot., datë 03.06.2019, për Draft Raportin e vlerësimit të jashtëm të programit MP në “Menaxhim Bankar dhe Financiar”. Në këtë dokument institucioni ka bërë disa komente për Draft-RVJ.

GVJ pasi u njoh me komentet e Institucionit mbi Draft-raportin e vlerësimit për programin e studimit në fjalë, sqaron si më poshtë:

GVJ në Draft Raport: “Në AU sistemi i menaxhimit të mësimdhënies online që është një sistem bashkëkohor për aksesin në kohë reale nga ana e studentëve mungon. Për këtë arsye GVJ rekomandon përdorimin e sistemit RASH (Sistemi Kombëtar i Menaxhimit) për të mbështetur studentin në procesin mësimor në mënyrë që ata të kenë akses nga sistemi në kohë reale të azhurnohen me materialet e hedhura nga pedagogu, leksione, materiale shtesë audio vizive etj.” fq.20

Koment i AU: Shërbimi i sekretarisë online ekziston dhe është në shërbim të studentëve. [Evidencë 1] Komunikimi i materialeve mësimore bëhet edhe nëpërmjet adresave të grupit nga pedagogët e lëndës ose nga departamenti..

Përgjigje GVJ: Merret parasysh e rregulluar si më poshte:

Rregulluar: Megjithëse pranë AU shërbimi i sekretarisë ofron online për studentet marrjen e materialeve mësimore si dhe informacionin rreth vlerësimit të rezultateve të tyre, institucioni duhet të adoptojë një sistem me bashkëkohor për aksesin në kohë reale nga ana e studentëve. GVJ rekomandon përdorimin e sistemit RASH (Sistemi Kombëtar i Menaxhimit) për të mbështetur studentin në procesin mësimor në mënyrë që ata të kenë akses nga sistemi në kohë reale të azhurnohen me materialet e hedhura nga pedagogu, leksione, materiale shtesë audio vizive etj.

GVJ në Draft Raport: “Pavarësisht se ka zhvillime pozitive nëpërmjet aksesit në burime ndërkombëtare elektronike për artikuj dhe libra shkencorë si *Questia*, apo përktime nga universiteti të disa teksteve bazë të njohura, fondi i titujve të librave/teksteve në shqip kryesisht të autorëve vendas në fushën e financës, bankës, Teorisë së protofolit etj., duhet të jetë më i gjerë.” fq.20.

Koment i AU: Fondi i bibliotekës pasurohet në mënyrë të vazhdueshme çdo fillim viti akademik [Evidencë 2] Studentët mund të shfrytëzojnë gjithashtu bibliotekën e departamentit, por tendenca e studentëve është më së shumti drejt materialeve të aksesueshme online.

Përgjigje GVJ: Nuk merret parasysh.

GVJ nuk e ndryshon Raportin përfundimtar

GVJ në Draft Raport: “Institucioni duhet të rrisë burimet financiare nga grandet apo kontributet si pjesëmarrës në projekte kërkimore shkencore dhe konsulencë pasi pesha e tyre në totalin e të ardhurave është e papërfillshme.” fq.21”.

Koment i AU: Institucioni ka dy projekte të fituara që po implementohen aktualisht: 1. GRADUA (Erasmus +) <https://www.graduaproject.com/partners/> dhe 2. HYPOSENS (H2020) <http://hyposens.eu/partners/>. Përpjekjet dhe aplikimet për projekte nuk kanë munguar edhe gjatë vitit akademik 2018-2019 [Evidencë 3].

Përgjigje GVJ: Nuk merret parasysh.

GVJ nuk e ndryshon Raportin përfundimtar

GVJ në Draft Raport: “Për të rritur cilësinë në hyrje të studentëve të këtij programi mendojmë se vendosja e një note mesatare “dysHEME” poshtë të cilës të mos mund të regjistroheshin studentë në program do të rriste cilësinë e tyre” fq.39”.

Koment i AU: Në vendosjen e kriterëve të pranimit për programin departamenti respekton legjislacionin në fuqi. Kontingjenti i studentëve që regjistrohen në program është i larmishëm; kryesisht të punësuar në profesion dhe me arritje akademike të mira [Evidencë 4].

Përgjigje GVJ: Nuk merret parasysh.

GVJ nuk e ndryshon Raportin përfundimtar

GVJ në Draft Raport: “Zyra e projekteve e institucionit duhet të jetë më aktive në procesin e bashkëpunimit shkencor në projekte të ndryshme, informimin e PAE lidhur me mundësitë e aplikimit deri edhe në ndërmarrjen e iniciativës për të aplikuar në kuadër të projekteve edhe si lider.” fq.42

Koment i AU: Institucioni ka përmirësuar ndjeshëm aktivizimin në aplikime të ndryshme projektsh [Evidencë 3]. AU ka struktura të dedikuara për kërkimin shkencor që punojnë për identifikimin e alternativave dhe partnerëve dhe shpërndarjen e informacionit në të gjitha palët që mund të përfshihen.

Përgjigje GVJ: Te hiqet tek rekomandimet

GVJ ndryshon Raportin përfundimtar

GVJ në Draft Raport: “Në mënyrë që stafi akademik të jetë i angazhuar në mënyrë të vazhdueshme në veprimtari kërkimore-shkencore duhet të ketë një mbështetje direkte nga institucioni nga ana financiare për kërkimin shkencor” fq. 42”.

Koment i AU: Institucioni përtej planifikimit në buxhet pranon dhe mbështet edhe nisma individuale të pedagogëve për pjesëmarrje në aktivitete shkencore [Evidencë 5].

Përgjigje GVJ: Nuk merret parasysh.

GVJ nuk e ndryshon Raportin përfundimtar

ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KESHILLIAKREDITIMIT NË VENDIMIN PËR AKREDITIMIN E PARË

I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit

Këshilli i Akreditimit në vendimene tij nr. 53, datë 10.07.2017 ka dhënëdy rekomandime për tu plotësuar:

- a) Të realizohet mbulimi i ngarkesës mësimore nga stafi akademik efektiv në masën 70%;
- b) Të ulet ngarkesa mësimore e stafit akademik të angazhuar në këtë programstudimi, nëpërmjet rekrutimit të stafit të ri akademik me kualifikimin enevojshëm.

II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

- a) Për rekomandimin e pare; “realizimin e mbulimit te ngarkesëmësimore nga stafi akademik efektiv (PAE)nëmasën 70 %”, nga shqyrtimi i dokumentacionit në institucion dhe verifikimin në vend konstatohet se në vitin akademik 2017-2018 ngarkesa mësimore nga stafi akademik efektiv u realizua në masën 80%dhe në vitin aktual akademik 2018-2019 në masën 87%.

- b) Për rekomandimin e dyte; “*uljen e ngarkesës mësimore te stafit akademik të angazhuar në këtë programstudimi, nëpërmjet rekrutimit të stafit të ri akademik me kualifikimin enevojshëm*”, Grupi verifikoi rekrutimin e stafit të ri me tituj dhe grada shkencore nga institucioni. Në vitin akademik 2017-2018 u rekrutuan si personel akademik efektiv (PAE) 2 pedagogë me titullin Prof. As., 1 pedagog me gradën Dr. dhe 1 pedagog me kualifikimin Master i Shkencave, ndërsa në fillim të vitit akademik aktual2018-2018 u rekrutuan si personel akademik efektiv (PAE) 2 pedagogë Doktorë të Shkencave.

Rekrutimet e dy viteve të fundit me PAE kanë bërë të mundur plotësimin e dy rekomandimeve të mësipërme duke arritur të mbulohet mbi 80 % ngarkesa mësimoreme PAE dhe të ulet ngarkesa mësimore e stafit akademik.

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Hartimi i programit të studimit Master Profesional (MP) në “Menaxhim Bankar dhe Financiar” është bazuar në misionin që ka vetë AU i cili kërkon të rrisëcilësinë në formimin akademik të studentëve dhe përgatitjen e specialistëve dhe kërkuesve të rinj në fushën e bankës dhe financës me dije të qëndrueshme teorik praktike. Në funksion të këtij misioni, programi MP në “Menaxhim Bankar dhe Financiar”, *synon të pajisë studentët me koncepte bazë të teorisë por para së gjithash me ato të aplikuara në bankedhe financë duke i gërshetuar njohuritë e marra në aspektin teorik me aftësitë praktike dhe aplikative.* Si rrjedhojë objektivi kryesor i këtij programi është që të arrijë të formojë ekspertë apo specialist me aftësi teoriko praktike e aplikative në fushën e bankës dhe financës. Në funksion të këtij objektivi kryesor është ndërtuar edhe kurrikula përkatëse, e cila nëpërmjet moduleve trajton aspektet teoriko praktike rreth bankave dhe menaxhimit financiar.

Në përputhje me ndryshimet e fundit në ligjin për arsimin e lartë, duke filluar nga viti akademik 2018-2019 programi ofrohet vetëm me kohëzgjatje normale një vit akademik, me gjithsej 60 ECTS.

Ky program bazohet edhe në strategjinë e zhvillimit institucional të AU duke u bazuar në literature mësimore bazë nga autorë të njohur ndërkombëtarisht në vendet e Europës dhe në SHBA si dhe në programe të bazuara në eksperiencën e universiteteve të mirënjohura në botë. Programi MP në “Menaxhim Bankar dhe Financiar” mbështetet në një kurrikul e cila përgjithësisht merr parasysh edhe zhvillimet ekonomik sociale të viteve të fundit si dhe kërkesat në rritje të tregut të punës për specialistë të aftë profesionalisht në fushën e bankës dhe financës, por edhe në profile të afërta me to.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;</p> <p>Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;</p>	<p>Programi i studimit MP në “Menaxhim Bankar dhe Financiar” në variantin me 60 ECTS është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimin kryesor të “Albanian University” (AU)-së, si dhe me misionin dhe qëllimin e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike si pjesë e këtij universiteti.</p>

Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.

Përgjithësisht programi i studimit MP në “Menaxhim Bankar dhe Financiar” është riorganizuar duke reflektuar ndryshimet në tregun e punës në përgjithësi dhe tregun financiar të punës në veçanti. Që nga akreditimi i parë me kusht në vitin 2016 vazhdon zgjerimi i tregut të punës në sistemin bankar e financiar, ku edhe mundësitë e punësimit të studentëve që përfundojnë këtë program janë në rritje.

Programi i studimit merr parasysh zhvillimet ekonomike të vendit, që nga akreditimi i parë me kusht dhe kryesisht kapërcimin e krizës financiare në ekonomi dhe veçanërisht në sektorin bankar dhe financiar. Gjate viteve të fundit (që përkohet me akreditimin e parë me kusht) në ekonomi kemi zhvillime strukturore dhe reforma të ndërmarra në sektorin e financës në kontekstin edhe të rritjes së rolit të këtij sektori. Tregu i punës ka aktualisht prirjen erritjes së kërkesave për specialist në sektorin bankar dhe financiar me njohuri sa më profesionale që mund të përmbushen tashme me programe MP me afate 1 vjeçare. Nga ana tjetër ky treg do të mund të përthithë ata student të programeve MP që do të mund të marrin njohuritësa me profesionale në Bankë dhe Financë.

Programi i studimit nuk bie ndesh me interesat kombëtare dhe çënimin e vlerave kulturore të vendit.

Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.

Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;

Programi i studimit MP në “Menaxhim Bankar dhe Financiar” në variantin me 60 ECTS është bazuar në Planin Strategjik të zhvillimit institucional 2017-2022 të hartuar nga AU. Në këtë Plan Strategjik që në fillim theksohet që gjate këtij 5 vjeçari institucioni do të përmirësojë dhe konsolidojë programet e studimit në kuadër të zhvillimit ekonomik dhe tregut të punës.

Ky program që është tashmë në vitin e 3-të zhvillimit të tij (pas akreditimit të parë me kusht) është riorganizuar me 60 ECTS në vitin akademik aktual 2018-2019 nga 90 ECTS që ka pasur në akreditimin e parë me kusht. Ky riorganizim është paraprirë në planin e zhvillimit të institucionit 2017-2018 si detyrim për të reflektuar kërkesat ligjore në fuqi.

Këto ndryshime janë fokusuar në cilësinë e mësimdhënies, të plotësisht të stafit efektiv dhe vazhdimësinë e programit me të gjitha ndryshimet në të. Programi bazohet tashmë në Kartën e Bolonjës që përcakton ndarjen e grupimit të lëndëve në kurrikulën e programit MP në “Menaxhim Bankar dhe Financiar” në variantet me 60 ECTS, në përputhje me standardet dhe praktikën më të mirë bashkëkohore..

Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Kriteri 1 Përmbatja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;

Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.

Programi i studimit MP në “Menaxhim Bankar dhe Financiar” është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Fillimisht programi Master Profesional në ‘Menaxhim Bankar dhe Financiar’ është vlerësuar me Vendim të Këshillit të Akreditimit nr. 300, datë 13.01.2012 dhe licencuar me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr.176, datë 26.04.2012. Me pas, bazuar në Vendimin e Këshillit të Akreditimit nr.181, date 07.07.2016 dhe Urdhrit të Ministrit Arsimit dhe Shkencës nr.441, date 25.08.2016 ky program studimi është akredituar me kusht. Me pas me Vendim nr. 53 date 10.07.2017 dhe nr.53/1 date 15.12.,2017, Bordi i Akreditimit ka dhënë akreditimin e pare ne përmbushje kryesisht te standardeve për studentet e regjistruar ne vitin akademik 2011-2012.

Bazuar ne kërkesat e Ligjin nr 80 date 17.09.2015 “Për arsimin e Larte dhe kërkimin shkencor ne institucionet e arsimit te larte në Republikën e Shqipërisë” i cili përjashton programet e ciklit te dyte te studimeve Master me 90 ECTS, institucioni beri dhe riorganizimin e këtij programi me 60 ECTS. Keshtu, bazuar ne Vendimin e Senatit te AU nr.6 date 28.02.2018, MASR me vendimin nr. 6313/2 Prot., datë 18.07.2018 ka miratuar riorganizimin e këtij programi nga 90 ECTS ne 60 ECTS me kohëzgjatje 1 vit që reflekton ndryshimet e bere në përputhje me kuadrin ligjor.

Ndërkohë,theksojmë që nga viti akademik 2018-2019 ky program studimi ofrohet 1 vit akademik me 60 kredite.Krahas plotësimit te akteve ligjore programi përmbush edhe kriteret nënligjore ne fuqi. Grupi i vlerësimit te jashtëm verifikoi kurrikulën dhe syllabuset e hartuara te programit te cilat ishin përgatitur sipas kriterëve të VKM nr.41 datë 24.01.2018 dhe udhëzimet e MASR.

Bazuar në emërtimin e programit ky program është në përputhje me orientimet e Kornizës Shqiptare të Kualifikimit. Emërtimi i programit është në përputhje jo vetëm me drejtimin e tij në financë por plotëson më mirë kërkesat për specialiste dhe menaxhere qe kërkohen nga sektori bankar e financiar me formim kryesisht profesional

Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.

Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;

Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.

Në Planin Strategjik te zhvillimit institucional 2017-2022 te hartuar nga AU janë përcaktuar edhe drejtimet kryesore të përmirësimeve për programet që zhvillohen nga institucioni. Në këtë strategji vihet si detyrë rishikimi i programeve në kuadër jo vetëm te përmirësimit te tyre por edhe te rregullimeve dhe plotësimeve te kërkesave te ligjit nr 80 date 17.09.2015 “Për arsimin e larte dhe kërkimin shkencor ne institucionet e arsimit te larte ne Republikën e Shqipërisë”..

Bazuar në Planin Strategjik të zhvillimit te institucionit që përcakton përmirësimin e mësimdhënies dhe mësimnxenies,

Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike dhe Departamenti i Shkencave Ekonomike që mbulon këtë program pranë AU-së vlerëson, monitoron procesin e mësimdhënies së stafit duke planifikuar vlerësim të vazhdueshëm periodik si dhe pjesëmarrjen e profesorëve apo specialistëve të ftuar në trajtimin e temave të fushës së bankës dhe financës, por edhe më gjerë.

Konkluzionet e vlerësimit:

Programi i studimit MP në "Menaxhim Bankar dhe Financiar" është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimin e AU-së dhe strategjinë e zhvillimit të tij.

Ky program është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi duke reflektuar ndryshimet në riorganizim rrjedhojë të tyre.

Programi është në përputhje me nevojat e tregut të punës si dhe të zhvillimeve në ekonominë kombëtare.

2. Struktura akademike e Fakultetit dhe departamentit përgjegjës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: përbërësit e njësive dhe stafet e tyre, kompetencat, baza e të dhënave të njësive, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Albanian University (AU) përbëhet nga strukturat akademike dhe administrative. Aktualisht AU përbëhet nga tre fakultete: Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike dhe Fakulteti i Shkencave Shoqërore, të strukturuar në njësi bazë (departamente dhe qendra). Në strukturën e UET renditen edhe njësitë administrative e mbështetëse.

Programi MP në "Menaxhim Bankar dhe Financiar" organizohet dhe zhvillohet nga Departamenti i Shkencave Ekonomike, pjesë e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike.

Fakulteti përbëhet nga organet drejtuese, autoritete drejtuese, njësitë bazë mësimore - shkencore dhe nga administrata. Njësitë bazë mësimore-shkencore janë:

- Departamenti i Shkencave Ekonomike,
- Departamenti i Arkitekturës,
- Departamenti i Inxhinierive.

Personeli akademik përbëhet nga pedagogët me kohë të plotë ose të pjesshme, si dhe personeli akademik i ftuar.

Struktura administrative e Fakultetit përbëhet nga:

➤ **Sekretaria Mësimore**

- Kryesekretari i Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike;
- Sekretari i Sekretarisë Mësimore;

➤ **Personeli ndihmës-akademik:**

- me karakter mësimor;
- me karakter administrativ;

Departamenti i Shkencave Ekonomike për realizimin e programit bashkëpunon në procesin e mësimdhënies me njësitë e tjera, në veçanti me Departamentin e Inxhinierisë përmes shkëmbimit të stafit dhe përdorimit të përbashkët të infrastrukturës. Këtë e eidentuam edhe nga verifikimi i angazhimit të pedagogëve të departamenteve të tjerë në procesin e mësimdhënies për lëndet e karakterit shkencor si matematikë apo informatikë.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Struktura akademike e Fakultetit

Organet dhe autoritetet drejtuese të **Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike** janë: Dekani, Asambleja e Personelit Akademik, Dekanati, 3 Departamentet e përmendura më lart, Përgjegjës të Departamenteve.

Parë në tërësi, mund të themi se kemi zbatim hierarkik të strukturës së **Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike** dhe Departamentit me organe të përcaktuara qartë që mbulojnë fushat përkatëse të kërkimit shkencor, mësimdhënies dhe atë administrative

Fakulteti në vitin aktual akademik 2018-2019 ka në përbërjen e tij **97** pedagogë personel akademik efektiv dhe me kontratë. Personel Akademik Efektiv (PAE) janë gjithsej **51** pedagogë, nga të cilët **26** pedagogë janë me tituj/grada shkencore ose afro 51 % etyre, ndërsa Personel Akademik me Kontratë (PAK) janë gjithsej **46** pedagogë, nga të cilët 36 pedagogë me tituj/grada shkencore ose 78 % 3 tyre.

Në aneksin e këtij raporti në **Tabelën nr.1** jepen të dhëna më të detajuara.

Struktura akademike e Departamentit

Departamenti i Shkencave Ekonomike është njësi bazë mësimore-kërkimore, që përfshin fushën e kërkimit në ekonomi, menaxhim, financë, kontabilitet, bankë dhe ekonomiks. Ky Departament ka patur ecurinë e zhvillimeve sasiore dhe cilësore që përmendëm më lart dhe që shprehet në të dhënat si si më poshtë:

Për vitin akademik 2017-2018 Departamenti përbëhet nga **28** pedagogë PAE, 16 me tituj/grada, dhe **23** pedagogë PAK, 18 me tituj/grada.

Për vitin akademik 2018-2019 Departamenti përbëhet nga **22** pedagogë PAE, nga të cilët **12** pedagogë me tituj/grada, dhe **22** pedagogë PAK, nga të cilët **16** pedagogë me tituj/grada.

Në përbërjen e këtij departamenti realizohet një ndarje sipas grup lëndëve të mëposhtme:

1. Grup-lëndët e formimit bazë;
2. Grup-lëndët "Menaxhim";
3. Grup-lëndët "Financë-Kontabilitet";
4. Grup-lëndët "Ekonomiks";
5. Grup-lëndët "Statistikë-Matematikë".

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga IAL, si dhe përmbajtja e raportit të vlerësimit të brendshëm dinamika e strukturimit akademik të fakultetit dhe departamentit është përgjithësisht e qëndrueshme, ku shihet vit pas viti rritja e kualifikimit të stafit akademik si dhe të peshës në mësimdhënien e PAE ndaj PAK.

Në aneksin e këtij raporti në **tabelën nr.2.1 dhe 2.2** jepen të dhëna më të detajuara mbi Departamentin.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Gjatë vizitës në institucion nga ana e GVJ u kërkua, në takimet me strukturat drejtuese të institucionit, personelin e Departamentit të Shkencave Ekonomike të dhëna shtesë dhe të fundit lidhur me evolucionin e stafit të këtij departamenti. Gjithashtu GVJ u njoh edhe me procedurat e rolit të Departamentit në procesin e

hartimit të programeve mësimore, kurrikulave, rekrutimit të personelit akademik gjatë vizitës në institucion etj. Të dhëna më të detajuara gjenden tek anekset e këtij raporti shih tabelat 1 dhe 2.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete;</p> <p>Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;</p> <p>Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;</p> <p>Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore “Doktor”.</p>	<p>Organizimi i AU, struktura e tij hierarkike është e ndërtuar në mënyrë të tillë që të përmbushë misionin dhe objektivat e përcaktuara prej tij por edhe të programit MP në “Menaxhim Bankar dhe Financiar duke ju nënshtruar edhe ndryshimeve gjatë viteve pas akreditimit të parë me kusht</p> <p>Universiteti përbëhet nga tre Fakultete te cilat përmbushin kriteret ligjore lidhur me numrin e njërive baze te tyre:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, i cili ka tre njësi bazë; 2. Fakulteti i Shkencave Shoqërore, i cili ka katër njësi bazë; 3. Fakulteti i Shkencave Mjekësore, i cili ka tre njësi bazë. <p>Departamenti i Shkencave Ekonomike si një nga tre njësite baze te Fakultetit te Shkencave te Aplikuara dhe Ekonomike ka 22 anëtarë PAE ndër të cilët 4 Profesorë të Asociuar, 8 Doktorë, 4 Doktorë në proces dhe 6 asistentë lektorë. Ky Departamenti qe mbulon këtë program ka të përcaktuar misionin dhe objektivat e zhvillimit të tij. Personeli akademik i Departamentit i përgjigjet si kërkesave ligjore ashtu edhe nevojave të institucionit për të mbuluar ngarkesën mësimore të programit/programeve të studimit.</p>
Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p>Njësia bazë mësimore shkencore e realizimit të programit MP në “Menaxhim Bankar dhe Financiar” është Departamenti i Shkencave Ekonomike. Departamenti operon në dinamikën e tij duke zhvilluar takime dhe diskutime periodike për problematikën e mësimdhënies, kërkimit shkencor etj. Ndër funksionet kryesore të departamentit përmendim: shqyrtimin dhe miratimin e planeve mësimore, programeve të lëndëve (syllabuseve), si edhe propozimin e ndryshimeve që gjykohen të nevojshme; shqyrtimin dhe miratimin propozimeve të përgjegjësve të grup- lëndëve për tekstet mësimore që do të përdoren në lëndët e programit të studimit; ndjekjen e realizimit të programit të studimit sipas planit të miratuar dhe mbikëqyrjen e cilësisë së mësimdhënies.</p> <p>Përgjegjësitë e njërive bazë janë të mirë përcaktuara në rregulloren përkatëse te funksionimit të Departamentit dhe në rregulloren e Fakultetit.</p> <p>Në procesin e rekrutimeve të personelit të ri akademik departamenti bën propozimet për profilin e nevojshëm të kandidatit për plotësimin e vendit vakant në përputhje me ngarkesën mësimore që ai nevojitet</p>

	<p>të plotësojë.</p> <p>Përgjegjësi i departamentit përgjigjet për vlerësimin e performancës së personelit akademik të departamentit gjatë vitit akademik. Kjo përfshin kryesisht korrektesën e tij në respektimin e orarit të punës, zhvillimin e mësimit, dhe përmbushjen e detyrimeve të tjera akademike, si edhe cilësinë e mësimeve në auditor dhe veprimtarinë e tij shkencore.</p>
--	---

Konkluzionet e vlerësimit:

Duke shqyrtuar dosjen e vetëvlerësimit, por edhe diskutimet që u kryen gjatë vizitës në institucion si dhe dokumentacioni që u paraqit për grupin e vlerësimit të jashtëm, GVJ vlerëson se struktura akademike e Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, si dhe Departamentit të Shkencave Ekonomike si njësi bazë e cila mbulon zhvillimin dhe administrimin e programit të studimit MP në ‘Menaxhim Bankar dhe Financiar’, është e organizuar në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi, dhe nevojat e këtyre njësive për të realizuar me cilësi programet e studimit në këtë program.

Ecuria e numrit të personelit të Departamentit të Shkencave Ekonomike, cilësia akademike e tij, procesi i menaxhimit të përditshëm të programit të studimit dhe roli i kësaj njësie bazë në hartimin e programeve, rekrutimin e stafit akademik dhe vlerësimin e performancës së antarëve të njësive plotëson standardin e rolit të njësive në realizimin e programit të studimit.

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Programi MP në ‘Menaxhim Bankar dhe Financiar’ i riorganizuar me 60 kredite tashme është në vitin e parë të tij dhe mbulohet si me PAE dhe PAK. Numri i PAE i angazhuar në këtë program është rritur me rekrutime të reja gjatë dy viteve të fundit duke arritur në 7 anëtarë staf të angazhuar si PAE kundrejt 2 anëtarëve të stafit të angazhuar si PAK. Përzgjedhja e anëtarëve të personelit akademik, si dhe vlerësimi i performancës së tyre rregullohet me dispozitat përkatëse në Statutin e AU dhe me dokument të veçantë. Të drejtat dhe detyrat e personelit akademik ngarkesa dhe format e saj përcaktohen në kontratën e lidhur mes tij dhe AU, bazuar në Kodin e Punës, në Statutin e institucionit, në rregulloret, në Kodin e Etikës si dhe në dokumente të tjera të miratuara nga organet drejtuese të institucionit.

Kërkesat për rekrutim të personelit akademik bëhet në fillim të vitit akademik nga njësitë bazë të Fakultetit që në rastin tonë është Departamenti i Shkencave Ekonomike tek Dekani i Fakultetit, i cili ia përcjell këto kërkesa Rektoratit që përcakton kriteret e pranimit dhe procedurat e konkurrimit. Vendet e punës për personelin akademik në AU fitohen nëpërmjet një procedure konkurruese. Kandidati i përzgjedhur fillimisht nënshkruan një kontratë afatshkurtër 3 mujore që shërben si periudhë prove dhe pas kësaj periudhe hartohet kontrata përfundimtare e punës mbështetur në Kodin e Punës, dhe në respektim të Legjislacionit për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë.

Kriteret kryesore mbi të cilat mbështetet rekrutimi i kandidatëve janë:

- Nota mesatare e programit të ciklit të dytë që ka përfunduar kandidatitete jete mbi 8 (tetë);
- Të kenë së paku gradën shkencore ‘Doktor’;
- Të kenë eksperiencë në mësime dhe eksperiencë profesionale, e lidhur me lëndën që dotë mbulojnë;
- Të zotërojnë aftësitë e nevojshme personale për vendin e punës;

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat, (Tabela3 në Aneks)

Numri i personelit akademik efektiv (PAE) dhe personeli akademik me kontratë (PAK) janë në përputhje me dispozitat ligjore për organizimin e strukturave didaktike për programet e studimit.

Për vitin akademik aktual 2018-2019 janë angazhuar në këtë program studimi 9 pedagogë gjithsej, nga të cilët 7 pedagogë janë PAE, nga të cilët 6 pedagogë me tituj/grada dhe 2 pedagogë janë PAK, të 2 me tituj/grada.

Raporti PAE/PAK në këtë program për vitin akademik aktual është 7:2;

Raporti PAE/Totalit të personelit akademik në këtë program për vitin akademik aktual është 7:9 ose 77 %;

Raporti pedagoqeve të përfshirë në zhvillimin e këtij programi/student për vitin akademik aktual është 47/9ose 1 pedagog për 5 studentë të regjistruar,

Bazuar në raportet e mësipërme, vihet re se ngarkesa mësimore në këtë program studimi për vitin akademik 2018-2019 mbulohet rreth 77 % nga staf i brendshëm PAE dhe rreth 23% nga stafi i jashtëm, PAK.

Raportet e dhëna mësipërm janë të mjaftueshme për numrin e studentëve aktualë të regjistruar në këtë program, gjatë vitit akademik aktual 2018-2019, vit kur programi ofrohet vetëm me 60 ETC.

- Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (Tabela 4 në Aneks)

Në aneksin e këtij raporti në tabelën nr. 4 jepen të dhëna më të detajuara.

Nga 7 pedagoge PAE, 6 prej tyre janë me tituj dhe grada shkencore, ndërsa të 2 pedagogët PAK janë me tituj dhe grade shkencore.

- Të dhëna sipas moshës së personelit(Tabela nr. 5 në Aneks)

Në aneksin e këtij raporti në tabelën nr. 5 jepen të dhëna më të detajuara.

Nga 9 pedagogët që mbulojnë këtë program 5 prej tyre janë të moshës 46-55 vjet; 3 pedagoge janë të moshës 25-35 vjet dhe 1 pedagog është i moshës 56-65 vjet.

- Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Nga verifikimi me zgjedhje që bëmetë disa dosjeve të PAE dhe PAK ne verifikuam elementet e kontratës së punës të lidhurme dy palëve e cila përcakton edhe detyrimet dhe të drejtat mes palëve të përcaktuara në Kodin e Punës dhe legjislacionin në fuqi.

- Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se stafi ndihmës dhe administrativ u shërbente të gjithë programeve në Fakultet. Angazhimi i tyre ishte serioz në mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe shkencor në institucion.Rekrutimi i stafit ndihmës/administrativ për Departamentin, bazuar në dokumentacionin e paraqitur ishte sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, por edhe rregullave të brendshmetë punësimit në AU.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.	
Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit	Bazuar në objektivat e programit MP në "Menaxhim Bankar dhe Financiar", vërehet angazhim serioz i personelit akademik dhe ndihmës

<p>angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësimesh shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	<p>për përmbushjen e tyre. Në syllabuset e miratuara të këtij programi janë shprehur qartë objektivat e mësimdhënies si dhe temat përkatëse për secilën prej moduleve të miratuara. Programi zbatohet tërësisht dhe ka një koordinim të personelit akademik me atë ndihmës dhe administrative. Leksionet e zhvilluara nga personeli akademik respektojnë programin/ syllabusin e miratuar duke marrë parasysh edhe lirinë akademike të titullarit të modulit përkatës.</p>
<p>Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.</p>	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion nga takimi me personelin akademik të Departamentit përgjegjës dhe stafin që mbulon këtë program, konstatoam që ai është përfshirë aktivisht në përgatitjen e programit si ne riorganizimin e kurrikules ashtu edhe ne përgatitjen e syllabusve për çdo modul. Ne konstatoam që për këtë qëllim është bashkëpunuar edhe me profesorë të njohur apo eksperte të financës dhe bankave me përvojë akademike. Vendimet për hartimin dhe rishikimin e programeve (kurrikulat dhe syllabuset) merren me propozim të njësisë bazë, departamenteve Ne verifikuam që kurrikula e programit (riorganizimi i tij) është diskutuar në mbledhjet e Departamentit (ne dt 14.2.2018) dhe vendimi i këtij të fundit është përcjelle instancave me të larta (Dekanit i cili pasi merr vlerësimin teknik nga Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave e ka kaluar e përcjell propozimin të Komisioni për Kurrikulat dhe Mësimin. Ky i fundit pas shqyrtimit e përcjell në Senatit Akademik i cili ka marrë vendimin përfundimtar për miratimin e tij ne datën 28.02.2018 dhe ia ka nisur shkresën përcjellëse MARS e cila ka miratuar riorganizimin e programit (rrjedhoje e ndryshimeve ligjore) ne 18.07.2018. Çdo anëtar i departamentit ka të drejtë të bëjë propozime dhe të argumentojë përpara kolegëve ndryshimet e propozuara. Për një rol më të rëndësishëm të personelit akademik dhe për një rritje cilësore të programit mendojmë që roli i Grupeve Mësimore Shkencore të Departamentit duhet të jete më i fuqishëm pasi janë antarët e çdo GMSH-je që kanë kompetenca profesionale më të mëdha në përcaktimin e lëndëve të kurrikulës dhe përmbajtjes së syllabuseve përkatëse. Para se gjithash rolin kryesor ne hartimin e këtij programi duhet ta ketë Grupi Mësimor shkencor i Finance Kontabilitetit. Gjithashtu, shqyrtimi i kurrikulës së programit dhe përmbajtjes së syllabusit duhet ti nënshtrohet një diskutimi më të gjerë dhe të hollësishëm në mënyrë që të eliminohen sa më shumë mbivendosjet në trajtim që mund të rezultojnë për disa lëndë.</p> <p>AU- ka një kuadër rregullativ të brendshëm mbi të cilin mbështetet procesi i punësimit të personelit akademik efektiv dhe me kohë të pjesshme(Udhëzimit nr. 29 dt. 10.09.2018).</p> <p>Kriteret shpallen publikisht dhe përzgjedhja bëhet me konkurs. Ne verifikuam me zgjedhje të rastësishme disa praktika rekrutimi të personelit akademik gjate dy viteve të fundit që janë angazhuar ne program dhe vlerësojmë zbatimin e kuadrit rregullativ të brendshëm institucionit. Në Zyrën e Burimeve Njerëzore dhe në Zyrën e Arkivit gjenden dosje të aplikantëve për punë, të komisioneve të intervistimit, vlerësimit të kandidatëve dhe njoftimeve për punë.</p> <p>Personeli i angazhuar në programet e ciklit të dytë realizon ngarkesën</p>

	mësimore sipas akteve në fuqi dhe kontratës së lidhur me AU.
Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se procedurat për rekrutimin e stafit akademik mbështeten në kuadrin ligjor në fuqi lidhur me rekrutimin e personelit si dhe në aktet e brendshme rregullative të institucionit në këtë fushë. Kriteret shpallen publikisht duke ofruar transparencën në treg.</p> <p>Personeli akademik efektiv në programin Master Profesional në Menaxhim Bankar dhe Financiar për vitin akademik 2018-2019 mbulon 87% të ngarkesës duke përmbyshur kështu, njërën nga kushtet kryesore të vena që në akreditimin e parë.</p> <p>Vlerësimi i cilësisë së veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore të personelit zhvillohet gjatë gjithë vitit akademik dhe përfshin të gjitha aspektet karakterizuese të saj:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimi nga përgjegjësit e departamenteve - Vlerësimi nga studentët - Vlerësimi nga njësia e brendshme e sigurimit të cilësisë <p>Të gjitha të dhënat që lidhen me procesin e rekrutimit ruhen në format elektronik dhe <i>hardcopy</i> pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe Zyrës së Arkivës dhe Protokollit.</p>
Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.	
<p>Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin "Profesor i asociuar" ose, gradën shkencore "Doktor" ("PHD") të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p> <p>Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve "Master i Shkencave" ka të paktën gradën shkencore "Doktor";</p> <p>Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve "Master profesional" ka të paktën gradën shkencore "Doktor" ose, diplomën "Master Profesional" ose "Master Shkencash" dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p> <p>Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>	<p>Aktualishtpërgjegjësi i programit, i cili është njëkohësisht edhe përgjegjës i Departamentit të Shkencave Ekonomike ka titullin Prof. As. Dr.</p> <p>Nga verifikimi i dokumenteve që kërkuan gjatë vizitës në institucion rezultoi se 8 nga 9 pedagogët që mbulojnë këtë program janë titullarë të lëndëve të angazhuar në zhvillimin e programit të studimit, me grada dhe tituj dhe vetëm një është Doktor në proces.</p> <p>Autoritetet drejtuese të institucionit janë të punësuar me kohë të plotë, në bazë të kontratës së punës të lidhur mes palëve, nuk u lejohet asnjë angazhim tjetër me kohë të plotë në institucione të tjera.</p> <p>Stafi akademik i angazhuar në këtë program ka një numër total prej 9 pedagogësh dhe e ka të mundshëm të mbulojë praktiken profesionale të studenteve (bazuar në raportin studente /staf akademik që është 47/9, ose 5 studentë, që duhet të mbikëqyrë një pedagog . Në këto kushte Departamenti i Shkencave Ekonomike gjatë viteve të mëparshme ka angazhuar personel shtesë për mbikëqyrjen e praktikave profesionale, të cilët kanë gradëndoktor e lart. Në ndihmë të studenteve për gjetjen e institucionit përkatës, departamenti ka bashkëpunuar me Zyrën e karrierës, në bazë të lidhjeve të saj me institucione të ndryshme financiare.</p>
Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave" apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.	
Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe	Departamenti i Shkencave Ekonomike si njësia bazë që mbulon

<p>studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (peshë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>zhvillimin e programit MP në “Menaxhim Bankar dhe Finance” përcakton edhe udhëheqësit shkencor për punimet e mikrotezës për çdo student të programit. Gjithashtu pedagogët udhëheqës të punimeve organizojnë takime periodike me studentët lidhur me ecurinë e realizimit të punimit duke synuar realizimin e një punimi sa më cilësor. Meqenëse ky program i riorganizuar është në vitin e parë të zhvillimit të tij Departamenti është në fazën e përcaktimit të drejtuesve të punimeve për studentet që vazhdojnë semestrin e dytë.</p> <p>Duke iu referuar RVB dhe vizitës në institucion, në departamentin e Shkencave Ekonomike udhëheqësi i punimit të mikrotezës kishte minimalisht gradë shkencore Dr ose titull akademik. Bazuar në numrin e personelit akademik të angazhuar në këtë program por edhe të gjithë personelit akademik të Departamentit dhe numrit të studentëve të regjistruar dhe diplomuar në këtë program ky kriter përmbushet.</p>
<p>Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.</p>	
<p>Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>Bazuar në kërkesën e studentëve dhe propozimin e tyre të fushës së punimit të mikrotezës në Departamenti i Shkencave Ekonomike përcakton edhe udhëheqësit shkencor për kandidatët. Miratimi i listës së udhëheqësve shkencor për çdo student u bëhet e ditur këtyre të fundit nëpërmjet shpalljes publike.</p> <p>Për vetë faktin e nivelit të kualifikimit të personelit akademik udhëheqësit e punimeve të studentëve të programit kanë kompetencat kërkimore për të realizuar këtë fazë përfundimtare të programit nga studentët.</p>
<p>Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Stafi ndihmës mësimor shkencor i organizuar si njësi me vete nëpërmjet 5 njësive të tilla (zyrës së IT-së, Financës, Burimeve Njerëzore, Informacionit dhe Arshivës) i angazhuar për ecurinë e procesit mësimor dhe shkencor (si mirëmbajtjen e laboratorëve të informatikës, dhe pajisjeve ndihmëse në auditorë, informacionin etj) ka kualifikimin e duhur dhe është në dispozicion të studentëve dhe pedagogëve përgjatë gjithë kohëzgjatjes së zhvillimit të mësimin. Gjithashtu personeli administrativ është gjithmonë në shërbim të studentëve dhe personelit akademik për të siguruar mbarëvajtjen e procesit akademik.</p> <p>Për të siguruar zhvillimin e rregullt dhe cilësor të praktikave profesionale në UET funksionon Zyra e Karrierës dhe Alumnit, e cila ka bashkëpunon me institucione publike dhe kompani private duke mbajtur komunikim të vazhdueshëm me ta, për të garantuar akomodimin e studentëve në këto institucione.</p> <p>Institucioni kujdeset për përdorimin optimal të burimeve njerëzore në funksion të realizimit të objektivave të programit, duke vendosur standarde për shpërndarjen e ngarkesës mësimore, dhe balancimin mes mësimdhënies dhe detyrave të tjera të personelit akademik.</p>
<p>Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	

<p>Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit MP në ‘Menaxhim Bankar dhe Financiar’, realizon ngarkesën mësimore sipas parashikimeve të kontratës së punës dhe akteve rregullatore të institucionit.</p> <p>Nga takimi me stafin dhe verifikimi i tabelës se ngarkesës mësimore të marre nga institucioni shihet që ajo është planifikuar në bazë të orëve mësimore (leksion dhe seminare si ore fizike) dhe që për 7 pedagogët PAE që mbulojnë këtë program ka një luhatshmëri relativisht të lartë.</p> <p>Kështu ka pedagoge që kanë një ngarkesë afro 400 ore fizike (përfshirë një pedagogë të Departamentit të Inxhinierisë që rezultojnë me ngarkesë mësimore prej afro 700 ore) dhe të tjerë me rreth 180 -200 ore ngarkesë. Nga ana tjetër 2 apo 3 pedagogë që mbulojnë këtë program zhvillojnë 3 deri 5 lëndë të ndryshme që në dy raste nuk janë të njëjtës natyre sipas disiplinave (finance banke, kontabilitet menaxhim etj).</p> <p>Kontrata e punës përcakton edhe elementët e tjerë të ngarkesës mësimore, si udhëheqjet e opionencat e diplomave dhe konvertimin e tyre në orë mësimore njësi.</p> <p>Për ngarkesën e stafit në të gjitha programet e studimit për vitin akademik 2018-2019, në dokumentacionin e sjellë nga institucioni rezultojnë:</p> <p>Stafi PAE:2 pedagogë mbulojnë përkatësisht 4 dhe 5 lëndë, 4 pedagogë mbulojnë 3 lëndë, dhe 1 pedagog mbulon 2 lëndë.</p> <p><i>Sa me sipër rekomandojmë që të jete një shpërndarje ngarkese mësimore me uniforme dhe të ulet sa të jete e mundur numri i lendeve që zhvillon një pedagog në të paktën 3 lende dhe të fushës përkatëse.</i></p>
<p>Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.</p>	<p>Bazuar në dokumentet bazë të funksionimit të AU, departamentet për programet e studimit dhe lëndët që mbulojnë, si dhe Zyra e Burimeve Njerëzore në nivel institucional, mbajnë të dhëna të detajuara në lidhje me personelin akademik të angazhuar në mësimdhënie, formën e punësimit, si dhe ngarkesën që mbulon çdo pedagog.</p> <p>Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik efektiv dhe me kontratë për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ;</p> <p>Kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik përcaktohen me dokument dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik, të veçantë pjesë e dokumenteve të AU dhe publikohen në faqen zyrtare në Internet të Universitetit .</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>Personeli akademik dhe mbështetës i programit MP në “Menaxhim Bankar dhe Financiar”i përmbush objektivat e programit dhe angazhimeve në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.</p> <p>Personeli akademik të cilët tërësisht janë me grada shkencore dhe tituj akademikë mbulon plotësisht nevojat e institucionit për këtë program dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë. Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	

PAE mbulon 87 % te ngarkesës mësimore te programit kundrejt 13 % qe mbulon PAK duke përmbushur mangësinë e vërejtur ne akreditimin e pare me kusht dhënë AU për këtë program.

Gjithashtu, me gjithë luhatshmërinë në ngarkesën mësimore te stafit te angazhuar në këtë program, dukshëm ka pësuar rënie në krahasim me ngarkesën e madhe të konstatuar ne akreditimin e pare.

AU ndjek procedura të qarta dhe transparente për rekrutimin e stafit akademik.

Rekomandojmë qe: Për një rritje cilësore të zhvillimit te programit te ulet numri i lendeve qe zhvillon një pedagog në jo me shume se 3 të tilla te të njëjtës fushë, si dhe të mund të zbutej më shume disproporcioni i ngarkesës mësimore mes pedagogëve

4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residenat.

Albanian University vazhdon të zhvillojë veprimtarinë e saj në të njëjtat ambiente të cilat ndodhen në qendër të kryeqytetit. Sipërfaqja totale e godinave të Universitetit është rreth 10718 m². Veprimtaria e Departamentit të Shkencave Ekonomike zhvillohet në të njëjtën godinë që prej vitit 2006 dhe ka një sipërfaqe totale prej 3996 m². Ajo është godina ku realizohet procesi i mësimdhënies në klasa dhe laboratorë të rikonstruktuar sipas kushteve bashkëkohore. Të gjithë auditorët janë të pajisura me video projektor dhe tryeza pune komode e të organizuara. Sallat dhe zyrat kanë të instaluar sistem kondicionimi ngrohje-ftohje, janë të pajisura me kompjuter, video projektor, ekrane të mëdha, flipcharte. AU ka aktualisht në përdorim 10 salla për leksione dhe 20 klasa për seminare me një sipërfaqe totale prej 2125.2 m²; 1 laboratorë për lëndët dhe 1 laborator informatike me sipërfaqe përkatësisht 50 m² dhe 35 m²,

Biblioteka njëkohësisht ishte e pajisur me PC në mënyrë që studentët të kishin mundësi të lexonin on-line. Ambientet universitare ishin të mbuluara me sinjal Wi-Fi në mënyrë që studentët të aksesonin lirisht webin. Të gjitha klasat mësimore ishin të pajisur me pajisjet audio vizive të nevojshme për zhvillimin normal të procesit mësimor. AU duhet të investojë në sisteme të cilat e mbështesin studentin në procesin mësimor në mënyrë që ata të kenë akses nga sistemi në kohë reale të azhurnohen me materialet e hedhura nga pedagogu, leksione, materiale shtesë audio vizive etj. Për të arritur këtë qëllim AU mund të përdorë sistemin RASH (Sistemi Kombëtar i Menaxhimit).

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Mjediset për mësimdhënien:

Bazuar në dokumentacionin e institucionit, raportin e vlerësimit të brendshëm, si dhe nga verifikimi që u bë gjatë vizitës në institucion rezultoi se AU ka në dispozicion për këtë programstudimi ambiente e përshtatshme për te realizuar procesin mësimor ne kushte optimale. Nga vizita qe grupi vlerësues i jashtëm bere ne ambientet e institucionit rezultoi se sallat e leksioneve, klasat e seminareve, laboratorët, salla e bibliotekës si dhe mjediset ndihmese ne funksion te realizimit te mësimi plotësonin parametrat e duhura ne funksion te këtij procesi.

Në aneksin e këtij raporti në **tabelën nr.6** jepen të dhëna më të detajuara

Mjediset për stafin:

Gjate vizites ne institucion grupi i vlerësimit te jashtëm beri edhe verifikimin e ambienteve për stafin akademik dhe ndihmës ne funksion te programit ku rezultoi qe numri dhe komoditeti i mjediseve dhe zyrave ne shërbim te stafit ishin te përshtatshme për te realizuar procesin mësimor e shkencor te tyre duke ofruar kushte optimale.

Në aneksin e këtij raporti në **tabelën nr.7** jepen të dhëna më të detajuara

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p> <p>Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p> <p>Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	<p>AU vazhdon te ketë te njëjtën vendndodhje që nga krijimi i tij në Prill 2004, në Bulevardin. Zogu i Parë, Tiranë. Për veprimtarinë e AU-së janë ne funksion katër godina ku zhvillohet procesi mësimor. Pozicioni i vendndodhjes dhe hapësirainfrastrukturorejanë optimale dhe te pajisura mire ne funksion te procesit mësimorshkencor. Institucioni ka afro 14 vjet që ka të njëjtën vendndodhje dhe infrastruktura e tij është përmirësuar vazhdimisht duke ofruar hapësira të nevojshme dhe komode.</p> <p>Zhvillimi i procesit mësimor te programit realizohet mjediset e selisë qendrore të AU, me një sipërfaqe totale prej 3996 m². Gjithashtu për një shfrytëzim optimal të infrastrukturës në dispozicion, mësimi në ciklin e dytë të studimeve zhvillohet i ndarë në dy grupe njëri prej tyre i zhvillon leksionet nga e hëna në të premte, 17:00-20:00 dhe tjetri të premte të shtunave 9:00 – 16:00. Kjo lehtësonpjesëmarrjen e studenteve ne procesin mësimor pasi një pjese e rëndësishme e numrit te studenteve te këtij program janë ne marrëdhënie pune.</p> <p>Institucioni zotëron mjedise te përshtatshme lidhur me punimet informatike duke ofruar salla laboratorë për lëndët dhe te informatikëspër studentet, me një sipërfaqe totale prej 85 m².</p>
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga</p>	<p>Për realizimin e këtij programi institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse. Në përgjithësi tekstet bazë janë në gjuhë shqipe (7 nga 10 lëndë gjithsej) libra kryesisht të autorëve shqiptar por edhe të përkthyer. Për disa nga lëndët ka tekste ndërkombëtare universitare të përkthyer nga autorë të njohur sidomos në fushën e bankave, tregjeve financiare, teoritë moderne të investimeve etj. Për të gjitha lëndët e ofruara ka dhe literaturë mbështetëse. Megjithatë, për vetë vështirësitë që ka përdorimi i tyre rrjedhojë e diferencave në ambientin ekonomik te vendit tonë me vendet e origjinës së librave të botuara, përdorimi i literaturës së huaj të përkthyer në shqip nga autorë vendas duhet të plotësohet edhe me cikle leksionesh dhe shembujsh afër realitetit të tregut shqiptar.</p>

studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;

Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.

Bazuar në vizitën që ne bëmë në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme, tekste mësimore në funksion të studentëve dhe stafit akademik. Në bibliotekën e godinës qendrore na u ofrua lista e 1200 titujve të disponueshëm për pedagogët dhe studentët, nga të cilët 331 tituj janë në ndihmë të programeve të shkencave ekonomike. Nga vizita pranë bibliotekës së AU rezultoi se hapësira e saj është optimale me rreth 170 vende leximi.

Bazuar në listën e inventarit të librave në fushën e ekonomisë biblioteka ofron rreth 1100 tituj librash në shqip dhe anglisht që janë në ndihmë të studentëve. Megjithatë, GVJ mendon që fondi i librave në dispozicion të studentëve duhet të ishte më i madh. Duke u mbështetur në lëndët që zhvillohen në programin MP në Menaxhim Bankar dhe Financiar rezultoi se ka gjithmonë nevojë për shtimin e literaturës lidhur me këto lëndë. Pavarësisht se titullarët e lëndëve e bazonin mësimdhënien në shumicën e lëndëve që zhvillohen në tekste të huaja të përkthyer ose të autorëve shqiptarë numri i teksteve alternative të lëndëve duhet të jetë më i larmishëm si në titujt në anglisht ashtu edhe në shqip. Pasurimi i fondit të bibliotekës me tituj librash në shqip dhe anglisht do pasuronte më tej fondin e bibliotekës dhe do u vinte në ndihmë studentëve.

Referuar RVB Biblioteka e AU është abonuar në librarinë elektronike "QUESTIA", e cila ka rreth 83.000 libra akademikë dhe mbi 10 milionë artikuj shkencorë.

Gjithashtu, biblioteka, ndërmarrja botuese Albanian University Press, revista e universitetit "Optime" kanë botime periodike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme që mundësojnë realizimin me sukses të programit të studimit, përgatitjen e tezës dhe projekteve kërkimore-shkencore.

Departamenti harton një plan të detajuar për zërat që do të shtohen në bibliotekë çdo vit akademik për t'u ardhur në ndihmë studentëve të programit. Referuar RVB dhe nga takimi në Departament pamë se ai harton një plan të shtimit të fondit të bibliotekës në mbështetje të programeve, por që për realizimin e tij e cila është pjesë funksionale e strukturave të tjera nuk ka mundësitë e zbatimit të plote të tij.

Biblioteka punon gjatë orarit 08.00-16:00. Orari është i shpallur në mjediset e institucionit dhe në hyrje të bibliotekës.

Biblioteka ka orarin e shërbimeve ekstra edhe në përputhje me oraret mësimore të studentëve për sezona të veçanta si ato të provimeve dhe riprovimeve.

Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.

Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;

Kriteri 2 Pajisjet e mjedisve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me

AU ka një infrastrukturë të përshtatshme për mësimdhënie të pajisura me mjetet e nevojshme teknologjike për zhvillimin e procesit mësimor efektiv. Të gjitha sallat mësimore janë të pajisura me PC dhe mjete audio vizive të cilat vijnë në ndihmë si studentëve

qëllimet e programit;

Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;

Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.

ashtu edhe stafit akademik.

Gjithashtu, për të përmbushur nevojat e programit AU ka në përdorim 1 laborator mësimor informatike, me një kapacitet prej 30 personash, të cilët janë të pajisura me PC, video projektor dhe mjete audio vizive, të cilat janë të përshtatshme për numrin e studentëve që i përdorin ato..

Pajisjet dhe programet e instaluar janë risitë e kohës në fushën e teknologjisë së informacionit.

Laboratori i informatikës është i pajisur me mjetet didaktike të nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor. Në PC-të e laboratorëve janë instaluar programet kompjuterike si SPSS, "Microsoft Office", qëndihmojnë studentët për punët dhe detyrat që kanë në programin e secilës lëndë apo edhe në temat e diplomave. Laboratori ka mundësi që t'ju shërbejë disa programeve të studimit, sipas një skedulimi normal të orarit të punës.

Konkluzionet e vlerësimit:

Mjediset e zhvillimit të veprimtarisë së institucionit dhe programit MP në Menaxhim Bankar dhe Financiar janë të përshtatshme dhe funksionale për zhvillimin normal të procesit mësimor, me sistem kondicionimi dhe sistem wireless. Çdo sallë mësimore është e pajisur me PC dhe projektor. Laboratori i informatikës është i pajisur me disa prej programeve të nevojshme të përcaktuara në programin mësimor. Personeli akademik i brendshëm është i akomoduar në zyrën për departamentin me sipërfaqe 21.3 m². Dekani është akomoduar në zyrë individuale, ndërkohë që zyra për departamentin dhe personelin akademik nuk janë individuale. Në dispozicion të departamenteve përdoret zyra e dekanit për zyre mbledhjesh. Biblioteka funksionon me orar zyrtar 08:00 – 16:00 dhe ofron kushte të mira. Fondi i bibliotekës ofrohet në formën e hard copy dhe elektronike, në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaja në mbështetje të studentëve.

Rekomandime:

- 1. Megjithëse pranë AU shërbimi i sekretarisë ofron online për studentet marrjen e materialeve mësimore si dhe informacionin rreth vlerësimit të rezultateve të tyre, institucioni duhet të adoptojë një sistem me bashkëkohor për aksesin në kohë reale nga ana e studentëve. GVJ rekomandon përdorimin e sistemit RASH (Sistemi Kombëtar i Menaxhimit) për të mbështetur studentin në procesin mësimor në mënyrë që ata të kenë akses nga sistemi në kohë reale të azhurnohen me materialet e hedhura nga pedagogu, leksione, materiale shtesë audio vizive etj.*
- 2. Pavarësisht se ka zhvillime pozitive nëpërmjet aksesit në burime ndërkombëtare elektronike për artikuj dhe libra shkencorë si Questia, apo për kthime nga universiteti të disa teksteve bazë të njohura, fondi i titujve të librave/teksteve në shqip kryesisht të autorëve vendas në fushën e financës, bankës, Teorisë së protofolit etj duhet të jetë më i gjerë.*

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare është një komponent i rëndësishëm që siguron mbarëvajtjen e procesit mësimor. Burim kryesor financimi janë tarifatat për dhe gjatë shkollimit të cilat zënë 98.4 % të totalit të të ardhurave, si dhe të ardhura të siguruar nga aktivitetet tjera tregtare (mensa, kafe, bare, rezidencat, etj.) Bazuar në raportin e GVB Institucioni ia ka dalë me sukses që të mbulojë me kosto financiare të gjitha

shërbimet e kërkuara. Institucioni ka një raport financiar për çdo vit buxhetor (për të gjitha vitet e kaluara) të hartuar dhe certifikuar nga ekspertë të jashtëm. Në raport ka të dhëna të hollësishme për të ardhurat nga tarifat e shkollimit, për pagat, sigurimet shëndetësore, sigurimet shoqërore, tatimin mbi të ardhurat personale, shpenzimet operative, etj..

Për pasqyrat financiare të çdo viti audituesi i pavarur ose audituesi ligjor ka dhënë opinionin në lidhje me pozicionin financiar, performancën dhe përputhjen me standardet e kërkuara të kontabilitetit. Pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë në të gjithadrejtimet aspektet materiale, si dhe rezultatit e operacioneve të saj dhe rrjedhjes së parasë për vitin e mbyllur.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi

Pjesa më e madhe e të ardhurave AU i siguron nga tarifat e studimit që zënë rreth 98% deri 99 % të të ardhurave totale

Në aneksin e këtij raporti në tabelën nr.8 jepen të dhëna më të detajuara.

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

Bazuar në të dhënat e deklaruara nga Institucioni në Raportin e Vlerësimit të brendshëm, kostoja për një student në programin e studimit Master Profesional në ‘Menaxhim Bankar dhe Financiar’ është 65 000 lekë/vit akademik.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	
<p>Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfuturave dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficientësinë e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>AU ka raport auditiv çdo vit nga një kontabël i miratuar dhe i regjistruar për situatën financiare, i cila bëhet mbi bilancin e çdo viti kalendarik, sipas standardeve përkatëse.</p> <p>Raportet përmbajnë transparencë në lidhje me kontabilizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe kategorizimin në llogaritë përkatëse, shfrytëzimin dhe eficientësinë e të ardhurave për funksionimin dhe rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe shërbimeve për studentët.</p>
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	<p>Institucioni bën një auditim të përvitshëm të situatës financiare të tij. Për secilin vit akademik institucioni harton raportin në lidhje me koston për secilin program studimi për të kontrolluar më lehtë ecurinë dhe vazhdimësinë konform rregullave dhe standardeve.</p> <p>Bazuar në numrin e studentëve të regjistruar gjatë gjithë viteve pas akreditimit të parë në programin MP në Menaxhim Bankar dhe Financiar që duhet konsideruar i kënaqshëm, si dhe në nivelin e tarifës që ata paguajnë për këtë program mendojmë se kjo siguron qëndrueshmërinë</p>

	financiare të programit të studimit. Njëkohësisht ky fond i siguruar i jep mundësi institucionit që të rrisë mundësinë e investimeve në shërbim të rritjes së shërbimeve për studentet dhe infrastrukturës së institucionit
--	---

Konkluzionet e vlerësimit:

Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare i plotëson standardet e kërkuara.

AU respekton standardin e hartimit të raportimit financiar dhe të evidentimit të kostos së studimit. Pasqyrat financiare përmbajnë transparencë në lidhje me kontabilizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Rekomandim:

Institucioni duhet të rrisë burimet financiare nga grandet apo kontributet si pjesëmarrës në projekte kërkimore shkencore dhe konsulencë pasi pësha e tyre në totalin e të ardhurave është e papërfillshme.

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njesisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë që nga viti akademik 2009-2010 është institucionalizuar si strukturë organizative në AU nëpërmjet ngritjes dhe operimit të njësisë së përhershme; Njesia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) e cila vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore e kërkimore, administrative e financiare të institucionit. Kjo njësi ka akses në të gjitha të dhënat e institucionit. Kjo strukturë në funksion të objektivave të saj bashkëpunon me Komisionin e Kurrikulave dhe Mësimin (KKM) dhe Komisionin e Përhershëm të Vlerësimit Institucional nga faza e diskutimeve deri në miratimin nga Senati të propozimeve të njësisë. Këto struktura bazojnë veprimtarinë e tyre në aktet ligjore si dhe rregulloren e brendshme të institucionit.

Veprimtaria e kësaj njësie bazohet në planin kalendarik të veprimtarisë së përvitshme, në të cilin programohen kontrollat në sektorët apo proceset që i nënshtrohen kontrollit e që shoqërohen me raportet me gjetjet përkatëse. Ndërkohë, në mënyrë periodike NJSBC informon drejtuesit e fakulteteve, e përmes tyre të gjithë stafin e AU rreth rezultateve të kontrolleve të zhvilluara, me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit, njësive të tij bazë dhe individëve në të ardhmen.

Në takimin e realizuar me anëtarë të kësaj njësie doli që fokusi i NJSBC-së është edhe:

- Formatizimi i syllabuseve (nga ana teknike sipas udhëzimeve me të fundit)
- Monitorimi i zhvillimit të provimeve
- Kërkimi shkencor, aktivitetet që zhvillon stafi akademik, botimet, trajnimet

Kjo njësi përbëhet nga 7 antarë. Në aneksin e këtij raporti në **tabelën nr.9** jepen të dhëna më të detajuara

Pjesë e rëndësishme e veprimtarisë së kësaj njësie është edhe vlerësimi i performancës së stafit nëpërmjet metodave indirekte dhe direkte. Mbi bazën e këtij vlerësimi hartohet raporti përkatës i cili i dërgohet instancave më të larta dhe pjesë të tij i dërgohen Departamentit. Një nga format më të përdorura mbi cilësinë mesimdhënëse në AU është pyetësori me studentët, i cili organizohet dy herë në vit, në përfundim të çdo semestri, për të gjitha programet e studimit, për të gjitha ciklet, për të gjitha lëndët dhe pedagogët. Skedat e pyetësorëve përpunohen përmes programit të përdorur për vlerësimin online dhe i vihen në dispozicion të drejtuesve të institucionit, si edhe në mënyrë të personalizuar për secilin pedagog. Njëherazi, ato janë një

burim i rëndësishëm për të nxjerrë konkluzione mbi cilësinë e punës së secilit, në disa raste janë shoqëruar edhe me marrjen e masave konkrete ndaj pedagogëve të ndryshëm.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:

- Sa anketime kanë bërë me studentët

Për te gjitha programet dhe lendet përkatëse te tyre realizohen 2 anketime në vit me studentët, një në përfundim të semestrit të parë dhe një në përfundim të semestrit të dytë. Meqenëse ky program është aktualisht ne vitin e pare qe zhvillohet i riorganizuar ne evidentuam nëpërmjet raportit përkatës qe ishte zhvilluar anketimi me studentet përgjithë lendet e semestrit te pare gjithmonë përpara sezonit të provimeve

- Sa studentë janë anketuar

Nga programi MP në 'Menaxhim Bankar dhe Financiar' në vitin akademik 2018- 2019 janë anketuar 50% e studentëve ose 24 studente

- Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë

Të gjithë të dhënat e mbledhura nga pyetësorët janë përpunuar si nëpërmjet analizave tabelore ashtu edhe te ilustruara me grafiket përkatës. Nga analiza e tyre ka rezultuar se, në përgjithësi, studentët janë shprehur pozitivisht por njëkohësishtkane dhënë edhe sugjerime te tyre përpërmirësimin e procesit te mësimdhënies.

- Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm

Pas përpunimit, rezultatet e pyetësorit janë diskutuar në nivel njësie bazë pranë Departamentit te Shkencave Ekonomike duke ruajtur konfidencialitetin dhe janë përcjellë në njësitë kryesore dheRektorat.

Kontrolli i brendshëm i cilësisë

Kontrolli i brendshëm i cilësisë realizohet nga strukturat përkatëse te sigurimit të cilësisë qe në nivel institucionalpërfaqësohet nga Njësia e Brendshme e Sigurimit te Cilësisë. Kjo e fundit bashkëpunon në nivel departamenti me Grupin e Sigurimit te Cilësisë, dhe me dy struktura te tjera;Komisioni për Vlerësim Institucional dhe Komisionin e Kurrikulave dhe Mësimit. Kontrolli i brendshëm i cilësisë së programeve të studimit realizohet në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë vitit akademik dhe veçanërisht në përfundim të semestrit të parë dhe në përfundim të vitit akademik. Ky vlerësim realizohet me përdorimin e metodologjive të ndryshme, si pyetësorë me studentët, fokus-grupe, raporte vetëvlerësimi të pedagogëve, etj. Të gjitha të dhënat e mbledhura pasqyrohen në raportet semestrale dhe vjetore të njësisë bazë dhe jepen rekomandime për përmirësime të mundshme në të ardhmen.

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti

NJSBC në funksion te objektivave të saj bashkëpunon me njësitë bazë nëpërmjet Grupeve të Sigurimit të Cilësisë të ngritura në nivel departamenti. Këto janë grupe ad-hoc të cilat përbëhen nga staf akademik i brendshëm i njësisë bazë, të cilët punojnë për rishikimin e kurrikulave dhe syllabuseve në bashkëpunim me lektorët e lëndëve, si dhe janë pjesë e grupeve të vlerësimit të brendshëm në rastet e akreditimit të programeve të studimit.

NJSBC përdor metoda te tërthorta dhete drejtpërdrejta gjate procesit te vlerësimit te mësimdhënies.

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

NJBSC krahas dy raporteve periodike semestrale harton edhe raportin vjetor te analizës se cilësisë së mesimdhënies duke parashtruar problematiken e dale nga dy format e metodave te tërheqjes se opinioneve te përmendua me lart. Gjithashtu kjo njësi ndjek edhe realizimin e problematikave te daladhe te parashtruara ne raport ne njësinë bazeqe është departamenti.

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Ne raportin vjetor te hartuar nga NJBSC krahas problematikave parashtrohen edhe sugjerime lidhur me përmirësimin ne te ardhmen te cilësisë mesimdhënese.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve; Sondazhe të vlerësimit të mesimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit; Pyetje konceptuale; Intervista; Etj. <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj.); Dëgjime në auditor; Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuar me nota/pikë; Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale; Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatat, projektet, provimet, etj.); Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës; Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës; Etj. 	<p>Bazuar ne organigramen e institucionit si dhe ne takimin e realizuar, sistemi i brendshëm i sigurimit te cilësisë ne AU realizohet dhe ndiqet nga dy struktura përgjegjëse te tij; Njësia e Sigurimit te Brendshëm te Cilësisë (NJSBC) dhe Komisioni për Kurrikulat dhe Mësimin (KKM).</p> <p>Vlerësimin e cilësisë së programit e prezanton nëpërmjet raporteve periodike pranë instancave vendimmarrëse përkatëse më të larta si dhe pranë Departamentit.</p> <p>AU nëpërmjet strukturave përkatëse kryen periodikisht vlerësimin e veprimtarisë akademike dhe administrative përmes metodash të tërthorta, kryesisht në formën e anketimeve me studentët, për të gjitha lëndët dhe të gjithë pedagogët. Rezultatet e tyre i vë në dispozicion të drejtuesve të institucionit, atyre të fakulteteve dhe departamenteve si dhe reflektohen në vlerësimin e performancës së çdo pedagogu në përfundim të vitit akademik. Institucioni realizon intervista me studentët, si edhe ato me pedagogët gjatë shqyrtimit të performancës së tyre. Ne verifikuam që në fund të semestrit të pare ishte zhvilluar anketimi online , ku nga 48 studente te programit MP ne “Menaxhim Bankar dhe Financiar” mbi 50 % te tyre kishin plotësuar pyetësorin dhe kishin shprehur vlerësimin e tyre rreth procesit te mesimdhënies.</p> <p>Në mënyrë sistematike nga ana e sektorit të statistikave përpunohen të dhënat mbi rezultatet e studentëve në studimet e tyre në institucion, kalueshmëria për lëndë dhe pedagog, etj.</p> <p>Për kryerjen e vlerësimit, përdoren metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:</p> <p><u>Të tërthorta:</u> Anketime me studentët qëndjekin programet e studimeve. Ky anketim zhvillohet dy here ne vit në fund te çdo semestri. Rezultatet e anketimit i bëhen te ditura stafit për te përmirësuar punën në të ardhmen. Nëse vlerësimi negativ përsëritet shikohet mundësia e largimit te tij nga mesimdhënia (siç na u referua një rast)</p> <p><u>Të drejtpërdrejta:</u> Vlerësimeme pikëpër stafin; Testime paraprake</p>

	dhepërfundimtare; Vlerësimi i detyrave të kryera ngastudentët, vëzhgime gjatë kryerjes sëusshtrimeve/praktikës etj
Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.	
<p>Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>AU përgatit dhe shpërndan në formën e një raporti vlerësimet periodike mbi cilësinë, i cili u vihet në dispozicion strukturave drejtuese që në nivel departamenti por edhe pedagogëve, sikurse dhe aktorëve të tjerë të interesuar.</p> <p>Këto raporte janë pjesë e diskutimit/ prezantimit në nivel në nivel departamenti, dekanati dhe rektorati</p>
Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>NJBSC bazuar në vlerësimin me pikë të procesit të mësimdhënies për çdo personel akademik mësimdhënës harton një raport periodik vjetor të ecurisë së programeve të nivelit Master mbi problematiken e dalë. Në funksion të kësaj problematike instancat drejtuese në qendër dhe ajo e njësisë bazë mësimore shkencore; Departamenti parashtrajnë masat që duhen ndërmarrë për përmirësimin e procesit dhe rritjen e cilësisë.</p> <p>Institucioni analizon mbi bazë fakulteti dhe departamenti ecurinë e programeve të studimeve, duke përfshirë edhe opinionin e studentëve.</p> <p>Mbështetur në vlerësimin e personelit akademik, dhe opinionit të shfaqur nga studentët, kryesisht të atyre të organizuar në “fokus grupe” dhe pyetësorët online, institucioni programon politika dhe ndërmerr masa për zhvillimin e mëtejshëm të programeve të studimit, për të reflektuar në to zhvillimet bashkëkohore me karakter teorik si dhe kërkesat e tregut të punës lidhur me aspektin praktik.</p>
Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedurën të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formale për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>Në kuadër të plotësimit të standardeve institucionale AU është akredituar dhe riakredituar, bazuar në legjislacionin në fuqi. Ky institucion është vlerësuar nga ekspertët e ASCAL në bashkëpunim me QAA për akreditimin institucional duke kaluar pozitivisht me kohëzgjatje 2 vjeçare, shprehur me Vendim të Bordit të Akreditimi nr. 90, dt. 20/10/2017.</p> <p>Sigurimi i cilësisë realizohet përmes përfshirjes së personelit akademik dhe atij ndihmës, ushtrimit të kontrollit nga ana e strukturave drejtuese dhe dy strukturave të rëndësishme në këtë drejtim që janë NJBSC dhe KKM-ja, tërheqjes së mendimit të studentëve, si edhe bashkëpunimit me ASCAL-in dhe strukturat tjera shtetërore. Kujdes i kushtohet zbatimit me rigorozitet të legjislacionit në fushën e arsimit, me fokusim të veçantë në standardet e cilësisë për të gjithanivelet. Në këtë kuadër, bën pjesë dhe riorganizimi i këtij programi MP nga 90 ECTS në 60 ECTS</p> <p>Institucioni ndjek procedurën e vlerësimit periodik, çdo vit, nëpërmjet raporteve të vlerësimit dhe pyetësorëve në çdo fund semestri.</p>

Programet e studimeve dhe syllabuset rishikohen çdo fillim viti akademik, me pjesëmarrjen e grupeve të sigurimit të cilësisë në nivel njësie bazë. Theksi vihet në përditësimin me literaturë bashkëkohore, ndryshimet në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Kjo realizohet në bashkëpunim edhe me Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave dhe KKM.

Institucioni në fillim të çdo viti akademik në javët orientuese sqaron studentët dhe stafin akademik mbi rëndësinë e vlerësimit të cilësisë dhe akreditimit të programeve të studimit. Avantazhet dhe disavantazhet që kanë këta të fundit nga vlerësimi cilësor dhe akreditimi i programeve të studimit dhe vlerësimi institucional.

Megjithëse roli i departamentit në përmirësimin e procesit të mësimdhënies lidhur me kurrikulen dhe programin është evident, mendojmë se riorganizimi i këtij program dhe hartimi i kurrikules së tij dhe syllabuset do të ishin me produktive nëse në faza të tilla të rëndësishme të merrej dhe një asistence /oponence e jashtme nga akademike dhe eksperte në këtë fushe. Kjo do të rriste cilësinë dhe do përmirësonte me mire programin përpara se ai të kalonte në dy strukturat e ngritura për këtë qëllim në institucion. Nga ana tjetër në evidentuam që NJBSC dhe KKM në përgjithësi analizojnë propozimet për ndryshime apo përmirësime në program apo kurrikul bazuar në kriteret teknike. Këto struktura e kanë të pamundur të bëjnë ndryshime thelbësore të përmbajtjes së programit apo kurrikules pasi nuk kanë eksperte në çdo fushe që mbulon një program.

Strategjia mbi sigurimin e vazhdueshëm të cilësisë zbatohet përmes veprimtarisë së strukturave drejtuese, aktivitetit të NJBSC dhe KKM dhe reflektohet në format dhe formatet standarde të publikuar në web-in e AU.

Konkluzionet e vlerësimit:

AU nëpërmjet NJBSC dhe KKM ,vlerëson periodikisht treguesit e veprimtarive mësimore, kërkimore dhe administrative të Institucionit, duke përdorur metoda direkte dhe indirekte të vlerësimit. Bazuar në shqyrtimet e detajuara dhe verifikimeve në institucion, konstatojmë se AU nëpërmjet këtyre dy strukturave të ngritura dhe organeve të tjera vendimmarrëse, duke filluar nga Departamenti i Shkencave Ekonomike dhe deri te Senati i Universitetit, përdorin instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herë pas herë të programeve përfshire edhe MP në “Menaxhim Bankar dhe Financiar”

GVJ rekomandon që për një rezultat me cilësor gjatë fazës së përmirësimit të programeve (përfshire edhe këtë program) që në fazën e diskutimit në njësinë baze, Departament është e nevojshme marrja e një asistence apo oponence të jashtme nga akademike dhe eksperte në këtë fushë.

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Programi i studimit MP në “Menaxhim Bankar dhe Financiar”, ofrohet nga Departamenti i Shkencave Ekonomike i cili është pjesë përbërëse e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike të AU.

Misioni i Programit MP në “Menaxhim Bankar dhe Financiar” është *përgatitja e studentëve me njohuritë teorike, profesionale dhe shkencore në fushën e menaxhimit bankar dhe financiar.*

Në funksion të këtij misioni, objektivi kryesor i këtij programi është *të pajisë studentët me njohuri të plota në fushën e bankave dhe financës me njohuri bashkëkohore të menaxhimit.* Duke njohur tregun e punës në këto fusha të diplomuarit e këtij programi kanë mundësi të mëdha për punësim në institucionet financiare private dhe publike si, specialist në bankat tregtare, menaxhere financiare të sipërmarrjeve etj. Në zhvillimin e programit ofrohen teknikat bashkëkohore të mësimdhënies, si laboratorë kompjuteri, lidhje interneti dhe një bibliotekë që ofron literaturën e kësaj fushe. Një drejtim tjetër i objektivit të këtij programi është të plotësojë studentet me njohuri të plota në një profil të ngushtë atë të menaxhimit bankar dhe financiar me mundësi aplikimi në segmente të tregut financiar apo institucionet financiare.

Ky program përfshin gjithsej 10 lëndë që si numër duhet konsideruar optimal bazuar në kreditet që ofron (60) dhe kohëzgjatjen 1 vit ku përfshihet edhe periudha e praktikës profesionale dhe punimi i diplomes.

Nga këto (sipas Tabelës 12, në Aneks):

- 2 lëndë prej tyre domethënë 10 % janë të karakterit të përgjithshëm (Kategoria A),
- 5 lëndë ose 40 % janë disiplina të formimit karakterizues (Kategoria B),
- 3 lëndë ose 30 % janë disiplina të ngjashme dhe/ose integruese dhe lëndë me zgjedhje (kategoria C),
- Praktika ose 10% (Kategoria D)
- Teza e diplomës ose 10% (Kategoria E).

Ideimi dhe hartimi i planit mësimor shumëdimensional të kurrikulës është bërë në përputhje të plotë me kërkesat e Kartës së Bolonjës, Frekuentimi i procesit mësimor (leksione, seminare, etj) është i detyrueshëm në masën 80%. Literatura në funksion të përgatitjes së një punimi diplome apo të përgatitjes në tërësi për një diplomim cilësor dhe në funksion të objektivave që përcakton programi i studimit, përgjithësisht ka qenë e zgjedhur mirë, por në disa raste është e përgjithshme, vetëm në një gjuhë të huaj dhe jo në dy a më shumë gjuhë. Kontrolli akademik i njohurive është realizuar korrekt dhe në përgjithësi janë respektuar format e kontrollit të njohurive të përcaktuara në syllabusin e lëndëve si edhe me shënimet përkatëse rreth përgjigjeve të pyetjeve me zhvillim. Literatura e ofruar për studentët është e viteve të fundit e mbështetur në literaturën bashkohore. Krahas literaturës së detyruar studentëve u jepet dhe literaturë e rekomanduar për të pasuruar.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Programi Master Profesional në ‘Menaxhim Bankar dhe Financiar’ është vlerësuar me Vendim të Këshillit të Akreditimit nr. 300, datë 13.01.2012 dhe licencuar me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr.176, datë 26.04.2012; është akredituar për herë të parë me kusht me Vendim të Këshillit të Akreditimit nr.181, datë 07.07.2016 dhe me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 441, datë 25.08.2016. Vendimi në fuqi për programin është vendimi i Bordit të Akreditimit nr. 53/2, datë 02.02.2018.

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojnë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Analizë e cilësisë së syllabuseve

Gjatë vizitës pranë institucionit u vlerësua cilësia e syllabusve të programit dhe njëkohësisht krahasuam ato me syllabuset e prezantuara në dosjen e Vetëvlerësimit të institucionit. Hartimi i syllabusve të programit përfshinte të gjitha elementet e nevojshëm duke plotësuar kriteret për to

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>AU, Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe të Aplikuara dhe Departamenti i Shkencave Ekonomike ofrojnë tashme njënumër programesh të nivelit Bachelor dhe Master të akredituara.</p> <p>Programi MP në 'Menaxhim Bankar dhe Financiar' që ofrohet në AU është vlerësuar për herë të parë me Vendim të Këshillit të Akreditimit nr. 181, datë 07.07.2016 dhe është akredituar me kusht me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 441, datë 25.08.2016 .</p> <p>Tashme në kuadër të riorganizimit të tij në funksion të plotësimeve të kërkesave ligjore programi është në kuadër të riakreditimit.</p> <p>Programi është i organizuar në përputhje me udhëzimet e MAS dhe lëndët e modulet vlerësohen me sistemin e krediteve ECTS.</p> <p>Duke shqyrtuar planin mësimor vëmë re që numri i krediteve për lende të veçanta varion nga 3 kredite në 6 kredite. Mendojmë që bazuar në metodologjinë e përcaktimit të krediteve për ledet e veçanta si dhe në mjaft eksperiencën të programeve në universitete të tjera numri i krediteve të përcaktuar për të dy lendet me zgjedhje që janë 6 kredite të mund të ulet dhe për lende të detyrueshme si "Drejtimi i Portofolit" apo "Metoda Kërkimi të Avancuara" të rritet. Kjo rrjedhë e vështirësive apo orëve të angazhimit jashtë auditorit që për lëndë e propozuara mund të jenë shumë.</p> <p>Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë programit MP në Finance nga një student që ndjek këtë program studimi me kohë të plotë është 60 kredite.</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave", "Master i arteve të bukura" apo "Master Profesional" i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare "Bachelor" me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve "Master i</p>	<p>Programi MP në "Menaxhim Bankar dhe Financiar", i pajis studentët që zotërojnë një diplomë në Bachelor në fushën e ekonomisë dhe financës, me njohuri më të thelluara teorike dhe praktike të fushës së banking-ut e financës duke u dhënë më shumë mundësi në tregun e punës.</p> <p>Programi bazohet mbi njohuritë e marra në ciklin e parë të studimit.</p>

<p>Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p> <p>Kriteri 7 Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Nga shqyrtimi i syllabusve vihet re që ka një trajtim të shpejte të koncepteve në financë që janë marrë në programin bachelor. Ky trajtim është i domosdoshëm në kushtet kur në këtë program kanë mundësinë që ta ndjekin edhe student që nuk kanë mbaruar studimet e ciklit të parë në fushën e financës apo ekonomisë.</p> <p>Programi arrin të pajisë studentët me kompetenca të përgjithshme në fushën e bankës dhe financës. Programi synon që të rrisë edhe kompetencat profesionale të studentëve me fokus rritjen e aftësive praktike që përfshijnë fushën e bankave, auditin apo financën.</p> <p>Mbështetur në 10 lëndët që ofron programi por edhe në praktikën profesionale të përfshirë në të, ai arrin të ketë objektiv formimin teoriko shkencor dhe relativisht edhe atë profesional të studenteve. Në këtë kuadër praktika profesionale dhe përgatitja e diplomës që synohet të jetë aplikative i shërbejnë këtij objektiv rritin me shume përgatitjen profesionale të studenteve.</p>
---	--

Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.

<p>Kriteri 1 Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p>Kriteri 2 Metodatat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Programi në përmbajtjen e tij ofron tiparet e një programi të nivelit të dytë në fushën e bankës dhe financës. Programi ndërtohet mbi njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimit, dhe thellon njohuritë dhe aftësitë e studentëve në përputhje me kriteret e vendosura.</p> <p>Nga verifikimi që bëhet gjatë vizitës në institucion rezulton kontrolli periodik i njohurive të marra me anë të testeve apo provimit përfundimtar. Format e mesimnxenies janë nëpërmjet vlerësimit periodik në seminare (për pjesëmarrje aktive), detyra kurse, provime të ndërmjetme dhe provim final. Përkatësisht studenti vlerësohet 10% për pjesëmarrje aktive në seminare; 10% për detyrat e kursit; 20% në provimin e ndërmjetëm dhe 60% në provimin përfundimtar</p>
---	--

Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disave çare dhe praktikatat e mira të vendeve europiane;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e</p>	<p>Programi në hartimin dhe zhvillimin e tij bazohet në eksperiencat bashkëkohore europiane dhe të vendit, si edhe duke vlerësuar nevojat e tregut të punës.</p> <p>Mbështetur në lëndët që përfshihen në të, programi arrin të trajtojë elementet e nevojshëm që lehtësojnë njohjen dhe ekuivalentimin e diplomës jashtë vendit, për qëllim vazhdimin e studimeve apo punësimin e studentit. Njëkohësisht programi është edhe një bazë e mire lidhur me mundësinë në të ardhmen për studentet e diplomuar për të pasur mundësinë e përfundimit të një Masteri me 120 kredite.</p> <p>Programi i studimit është në përputhje me objektivat e përcaktuara në</p>
--	---

lartë dhe profesionet e rregulluara.	legjislaionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.
--------------------------------------	---

Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.

Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;

Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;

Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;

Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.

Bazuar në misionin dhe objektivat e tij, programi synon para se gjithash aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor. Në kushtet kur ky program realizohet brenda një viti kalendarik, përfshin trajtimin e 10 lëndëve dhe në total ofron 60 ECTS, aftësimi profesional duhet të zërë më shumë vend në të. Mbështetur edhe nga interesat e studentëve që preferojnë të regjistrohen në këtë program që konsiston në rritjen e aftësimin profesional nëfushën e menaxhimit bankar dhe financiar *mendojmë se programi në lëndë të caktuara që ofron apo trajton duhet të ketë më shumë trajtime praktike.*

Sa më sipër, për ti dhënë përparësi trajtimit profesional mendojmë që 2-3 lende të programit janë kryesisht të nivelit të lartë teoriko shkencore dhe kërkojnë baze të fuqishme teorike nga programi bachelor. Kështu, lendet; “Metoda kerkimi të avancuar”, “Teoria moderne e Investimeve” dhe “Drejtimit Portofoli” nuk i përgjigjet nivelit të këtij programi po të kemi parasysh se studente të mundshem në këtë program janë edhe ata që mund të kenë mbaruar programin Bachelor në ekonomi apo biznes dhe që synojnë të marrin njohuri profesionale në Banking dhe Financë. Nga ana tjetër duke mos patur kriter minimal hyrës lidhur me notën mesatare nga programi bachelor, niveli një pjese studentesh potencial mund të jete i ulët duke mos mundur të përvetësojnë lende të tilla të përmendura me lart. Dihet që të trajtosh këtë lëndë duhet një bazë e fuqishme teorike dhe zotërimi i disa lëndëve që janë karakteristike e trajtimit në Master Shkencor (të tilla si “Ekonometri”, “Statistike biznesi” etj). Mendojmë që në kuadër të hapësirave ligjore dhe nënligjore të ndryshimeve në kurrikul mund të shihet mundësia e zëvendësimit të lendeve të mësipërme lende me profesionale të fushës së programit si Marketingun Bankar, Kreditin bankar, etj.

Mbështetur në temat që trajtohen në çdo lëndë të shprehura në syllabuset konceptet dhe trajtimet teoriko shkencore zënë vend në një pjesë të konsiderueshme nëto.

Aftësimi shkencor i studenteve do të arrihet më mirë edhe gjatë përgatitjes së punimit të diplomës ku konsultimi dhe ndihma e udhëheqësve të diplomës do të kontribuonin në përgatitjen e një punimi sa aplikativ aq edhe shkencor.

Programi i studimit është në përputhje me strategjinë e zhvillimit të AU. Ky program kërkon që në përputhje me strategjinë e zhvillimit institucional të AU të arrijë të përthithë studentë që kanë interesa profesionale në tregun e punës si dhe ngritje teorike të nivelit të tyre.

	<p>Ne mendojmë që ende edhe përnjë periudhe afatmesme (2-3 vitet e ardhshme) ka një numër të konsiderueshëm studentësh potencial që do të preferonin kryerjen e një programi me jetëgjatësi 1 vit kalendarik me përfitime kryesisht në tregun e punës dhe ngritjen teorike të tyre.</p> <p>Nëse e shikojmë këtë zhvillim të ardhshëm në një periudhe kohore me te gjate të zhvillimeve në treg mendojmë se AU-së do ti duhet të zhvillojë program MP në “Menaxhimin Bankar dhe Financiar” me kohëzgjatje 2 vite (përfshirë periudhën e përgatitjes së punimit të mikrotezes që është 1 semestër) dhe me 120 ECTS.</p> <p>Mbështetur në vlerësimet periodike që bën institucioni personeli akademik angazhohet në punën kërkimore jo vetëm në interes të ecjes përpara profesionalisht, por dhe për të përmbushur detyrimet sipas kontratës së nënshkruar me AU. Rritja e punës së tyre kërkimore shkencore i shërben edhe rritjes cilësore të mësimdhënies në këtë program.</p>
--	---

Standardi I.7 - Programet e studimeve “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p>	<p>Programi që ofrohet ka natyrë teoriko aplikative dhe synon të përgatisë specialiste në tregun bankar dhe financiar, treg ky që është në zhvillim sasior dhe cilësor. Këtë e shohim jo vetëm në vazhdimin e zgjerimit të tregut bankar dhe të sigurimeve në Shqipëri por dhe të nevojave të sektorit privat për menaxhere financiar.</p> <p>Mbështetur në lëndët e ofruara në program vërejmë se një pjesë e konsiderueshme e tyre janë disiplina të formimit karakterizues (5 nga 10 gjithsej) dhe disiplina të ngjashme me to (3 lëndët e ndër-disiplinore). Kjo ndarje e lendeve dhe krediteve që ato kanë jo vetëm plotëson kriteret e peshës specifike që duhet të kenë grup lendet por bën edhe një ndarje të qarte mes tyre. (tabela nr.12 në aneks)</p>
---	---

Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar; kërkesat e punëdhënësve; një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Në Korrik 2016, AU ka përgatitur studimin e tregut të punës i cili është i plotë pasi analizon mundësitë e punësimit për të gjithë programet duke përfshirë edhe tregun bankar dhe financiar. Studimi njëkohësisht argumenton rritjen e kërkesave për specialiste në tregun bankar e financiar. Numri i studenteve të regjistruar në këtë program gjatë 6 viteve pas akreditimit të parë dhe aktualisht tregon se kjo kërkesë ka reflektuar kërkesat e tregut të punës në fushën e bankës dhe financës. Ky treg është zgjeruar edhe në segmente të tij sidomos po të kemi parasysh zhvillimet pozitive në tregun e bankar, auditimit dhe menaxhimit financiar.</p> <p>Nga takimet që patëm në institucion vumë re se AU analizon vazhdimisht zhvillimet në tregun e punës, duke u fokusuar në mundësitë e punësimit të studentëve, identifikimin e qartë të kërkesave të punëdhënësve në mënyrë ato të gjejnë përgjigje në zhvillimin e programit të studimit</p> <p>Nga ana tjetër një pjesë e studentëve që janë të regjistruar në këtë program janë të punësuar dhe kanë kërkesa për të bërë karrierë në këtë treg apo të specializohen më tej në segmente të tregut financiar dhe</p>
---	--

	<p>bankar.</p> <p>AU parashikon qe edhe për 2-3 vitet e ardhshme numri i studenteve të regjistruar të ketë të prirje ne rritje.</p>
<p>Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Programi i studimit është në përputhje me këto dy kritere.</p> <p>Gjatë hartimit dhe rishikimit të programeve të studimit janë mbajtur parasysh objektivat kombëtare të zhvillimit. Në qendër është formimi i studentëve që të jenë të aftë për punë në shërbim të shoqërisë.</p>
<p>Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve “Master i Shkencave” realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;</p>	<p>N/A</p>
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve “Master Profesional” realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.</p>	<p>Këtë vit akademik, programi ofrohet me 60 kredite. Kohëzgjatja normale e programit është 1 vit akademik. Punimi i diplomës dhe praktika profesionale realizohet me 12 ECTS.</p> <p>Më parë programi është ofruar me 90 kredite ECTS. Kohëzgjatja normale e tij ka qenë 1.5 vite, në përputhje me parashikimet ligjore te atëherëshme në fuqi.</p>
<p>Kriteri 3 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës “Master i Shkencave”. Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).</p>	<p>N/A</p>
<p>Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;</p> <p>Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.</p>	<p>Programi i studimit, me lëndët përbërëse të tij, sipas viteve dhe semestrave është i publikuar në faqen e internetit të AU.</p> <p>Gjithashtu, studentët në fillim të secilit semestër informohen gjerësisht dhe pajisen me të gjithë syllabuset e lëndëve, ku jepen në detaje temat e lëndës, literatura kryesore, forma e kontrollit të dijeve, literatura e rekomanduar.</p> <p>Ky informacion tashmë është edhe elektronikisht, ku çdo student shih gjithë materialet e lëndës që pedagogët vendosin në portal, krahas syllabusit.</p>
<p>Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.</p>	

<p>Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;</p> <p>Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve “Master i Shkencave” janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion ne verifikuam dhe konfirmuam që AU ka dokument të shkruar që shpjegon dhe instrukturon studentët për procedure dhe mënyrën e përgatitjes së punimit të diplomës edhe për nivelin e dytë të programeve ku përfshihet edhe MP në “Menaxhim Bankar dhe Financiar”. Ky dokument u behet i qartë studentëve dhe gjatë periudhës së përgatitjes së punimit të diplomës udhëheqësi mbikëqyre edhe zbatimin rregullave të përcaktuara në këtë dokument Gjithashtu rol të rëndësishëm në këtë proces kanë edhe pedagogët udhëheqës të punimeve të mikrotezes.</p>
---	--

Konkluzionet e vlerësimit:

Departamenti i Shkencave Ekonomike i AU ofron programin e studimit MP në “Menaxhim Bankar dhe Financiar” i cili ofrohet në vitin akademik aktual 2018-2019, në variantin 60 ECTS. Studimet në këtë program organizohen në module dhe vlerësohen në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe të Grumbullimit të Krediteve (ECTS).

AU dhe Departamenti i i Shkencave Ekonomike si njësi kryesore ku programi zhvillohet ofron informacionin e plotë të këtij programi për të interesuarit nëpërmjet faqes së internetit ku përfshihen; lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër, ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ndjekjen e programit, syllabuset e detajuara për secilën lëndë, etj.

Bazuar në RVB, takimet e realizuara gjatë vizitës në institucion, dhe dokumenteve të kërkuara dhe marrë nga institucioni konkludojmë se programi i studimit MP në “Menaxhim Bankar dhe Financiar” është në përputhje me misionin, objektivat, strategjinë e AU si dhe kërkesat e legjislacionit në fuqi.

Rekomandojmë:

- Në kuadër të hapësirave ligjore dhe nënligjore të ndryshimeve në kurrikul në vitet e ardhshme të mund të shihet mundësia e zëvendësimit të 2 deri 3 lendeve (të përmendura më lart) që janë kryesisht të nivelit teorike shkencor (ndofta për një program Master Shkencor) me lëndë të karakterit më profesional (te fushës së programit si Marketingun Bankar, Kreditin bankar, etj.) duke ju përgjigjur kështu edhe nivelit të mundshëm të studenteve që do të regjistrohen në të ardhmen në këtë program.
- Mendojmë që bazuar në metodologjinë e përcaktimit të krediteve për lëndët e veçanta si dhe në mjaft eksperiencën të programeve në universitete të tjera numri i krediteve të përcaktuara për të dy lëndët me zgjedhje që janë 6 kredite të mund të ulet dhe për lende të detyrueshme si “Drejtimi i Portofolit” apo “Metoda Kërkimi të Avancuara” të rritet.

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Mësimdhënia në programin MP në Menaxhim Bankar dhe Financiar bazohet në Rregulloren mësimore të programit të studimit e cila përcakton format e mësimdhënies dhe vlerësimin e dijeve të studentëve. Procesi mësimor zhvillohet nëpërmjet formave të mirënjohura; leksione, seminare, leksion/seminare, detyra kursi, ushtrime etj, të organizuara në 12 module, ku janë parashikuar 10 provime, praktika dhe tema e diplomës. Lëndët klasifikohen në dy grupe kryesore: lëndë të detyruara dhe lëndë me zgjedhje.

Në këtë program lëndët zhvillohen sipas syllabusit të çdo lënde dhe në liri të plotë të personelit akademik. Kontrolli i njohurive të studentëve përcaktohet në Rregulloren mësimore të programit të studimit. Për të ruajtur objektivitetin e vlerësimit forma e kontrollit në program është me shkrim dhe e sekretuar. Në politikën e Institutit është praktikë që nota e studentit të jetë e “ndërtuar”, kjo do të thotë që studentit testohet gjatë

semestrin në secilën lëndë përveç provimit përfundimtar në sezon. Shumatorja e pikëve të mbledhura përbën vlerësimin e tij përfundimtar. Forma e vlerësimit realizohet në përputhje me vendimet e Senatit të Albanian University. Mënyra e vlerësimit të studentëve është e prezantuar në syllabusin e lëndës.

Për koordinimin e vazhdueshëm të punës së personelit akademik, në përputhje me planet strategjike, veprimtaritë dhe procedurat e miratuara, Departamenti organizon mbledhje të zakonshme, në disa prej të cilave marrin pjesë përfaqësuesit e studentëve.

Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies së personelit akademik kryhet nga Departamenti dhe NJSBC nëpërmjet monitorimeve të vazhdueshme. Është e detyrueshme që nga ana e çdo pedagogu dhe nga ana e vetë departamentit të bëhet një raport semestral (raport tip).

Gjithashtu, nga çfarë na u konfirmua edhe në vizitat në institucion, përdoren edhe instrumenta të tjerë të vlerësimit të mësimdhënies të cilat janë:

- ✓ anketa e studentit ku vlerësohet mësimdhënja dhe personeli akademik sipas disa kritereve të përfshira në pyetësorin e vlerësimit
- ✓ focus - grupet

Rezultatet e përpunuara u bëhen me dije personelit akademik të interesuar dhe autoriteteve drejtuese Sekretaria Mësimore mban evidencat për zhvillimin e orëve të mësimin, leksione/seminare. Ajo raporton në fund të çdo jave, për orët e pazhvilluara te Sekretari i Përgjithshëm, te Dekanët e Fakulteteve dhe te Zyra e Burimeve Njerëzore.

Sa i takon cilësisë së mësimdhënies, shohim përmbushje të standardeve të brendshme në lidhje me cilësinë e organizimit të lëndëve, përzgjedhjes së literaturës (në gjuhë të huaj dhe shqipe), si dhe mjeteve e metodave të larmishme didaktike të përdorura gjatë leksioneve dhe seminareve. Cilësia e mësimdhënies lidhet ngushtë me fushën e ekspertizës apo interesave kërkimore shkencore të pedagogëve, të cilat janë pasqyruar në artikuj e botime të tjera shkencore, workshope dhe konferenca. Ndërkohë studentët janë shprehur pozitivisht për cilësinë e mësimdhënies dhe marrëdhëniet akademike me pedagogët e angazhuar për zhvillimin e lëndëve të programit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet

Duke analizuar format e mësimdhënies dhe strukturën e elementeve të tyre (leksione seminare ushtrime etj,) shohim që nga 612 ore të planifikuara, zhvillimi i leksioneve zë 150 ore ose afro 25 % , zhvillimi i ushtrimeve zë rreth 39 % dhe zhvillimi i seminareve zë rreth 15 %.

Në aneksin e këtij raporti në **tabelën nr.13** jepen të dhëna më të detajuara

- Format e kontrollit të njohurive

Format e kontrollit të dijeve përfshijnë vlerësimin e vazhdueshëm që në total zë 40 % kundrejt vlerësimit në provimin përfundimtar që zë 60 % të vlerësimit total. Vlerësimi i vazhdueshëm përfshin elementet që karakterizojnë angazhimin e vazhdueshëm të studenteve nëpërmjet detyrave të kursit, punëve laboratorike testimeve etj.

Në aneksin e këtij raporti në **tabelën nr.14** jepen të dhëna më të detajuara

- Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj (Tabela 15 në Aneks):

Meqenëse ky program i riorganizuar është në vitin e parë të zhvillimit të tij dhe studentet sapo kanë përfunduar semestrin e parë nuk ka të dhëna për numër studentesh të aktivizuar. Por nga vitet e kaluara ka pasur angazhim të studenteve në aktivitete shkencore në rang institucioni , fakulteti apo departamenti.

Në aneksin e këtij raporti në **tabelën nr.15** jepen të dhëna më të detajuara

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Në takimin e bërë me personelin akademik dhe me grupin e vlerësimit të brendshëm na u komunikua se studentët e programit MP në Menaxhim Bankar dhe Financiar kanë marrë pjesë në evenimente të organizuara nga Departamenti. Aktivitete të tilla kanë përfshirë seminare, konkurse, samite apo forume të organizuara nga AU

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Pranimi i studentëve në programin MP në Menaxhim Bankar dhe Financiar që ofrohet nga AU bazohet në kuadrin ligjor dhe rregullativ në fuqi si dhe në kriteret dhe procedurat e përcaktuara nga institucioni. Gjatë vizitës në institucion ne verifikuam me zgjedhje procesin e regjistrimit të studentëve në këtë program duke parë përmbajtjen e dosjeve të studenteve të regjistruar. Fillimisht u pa regjistri themeltar dhe në këtë program studimi rezultoni të regjistruar 47 studentë, memesatare hyrëse 6.8. Nga verifikimi në regjistër rezultoi se 36 studentë ishin me numër matrikullimi dhe 11 të tjerë pa numër matrikullimi. Arsyetimi dhënë nga sekretaria mësimore për mungesën e matrikullimit janë si më poshtë:

- Përgjigja e parë nga ministria ka ardhur para dy – tre javësh (vonesa të AKP)
- Problem i dublimit të matrikullave
- Problem i studentëve që vijnë nga Universitetit Kristal (vonesë në vërtetimin e vlefshmërisë së diplomës nga Ministria)
- Vonesë në ekuivalentimin e diplomës

Nga procesi i zgjedhjes rastësore në dosjen e regjistrimit gjendeshin dokumentet e plotësuar të mëposhtme:

- Fotografi
- Mandat pagesa
- Deklarata e studentit
- Kontrata e studentit
- Formulari i aplikimit
- Diploma e Bachelor-it
- Diploma e maturës
- ID – Karta e identitetit/pasaporta

Sekretaria mësimore e AU-se disponon statistika të detajuara vjetore për numrin e të diplomuarve për çdo program dhe cikël studimi në bazë viti akademik. Procesi i seleksionimit organizohet dhe drejtohet sipas rregullores së organizimit të programit rregullores së regjistrimeve dhe transferimeve dhe sipas vendimeve të autoriteteve drejtuese. AU mundëson transferimin e studentëve në vite ndërmjetëse brenda ciklit të dytë, midis programeve të njëjta ose të ngjashme studimi, si brenda të njëjtit institucion apo institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë, private ose publike, vendase ose të huaja, si dhe lejon transferimin e studentëve të saj në shkolla të tjera të arsimit të lartë sipas procedurave të parashikuara në rregulloren mësimore dhe në rregulloren e regjistrimeve dhe transferimeve.

Veçori e studenteve të regjistruar në programin MP në Menaxhim Bankar dhe Financiar është fakti se një pjesë e konsiderueshme e tyre janë në marrëdhëniepunësimi. Numri total i të punësuarve në përputhje me diplomën për periudhën 2017 – 2019 ishte 39 nga 60 në total.

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

- Procedurat e pranimit të studentëve

Procedura e pranimit të studentëve në programin MP Menaxhim Bankar dhe Financiar bazohet krahas bazës ligjore dhe akteve nënligjore edhe në rregullat e brendshme të AU-së (me hollësisht shih më sipër)

- Cilësia në hyrje dhe në dalje të studentëve

Gjatë vizitës në institucion u kërkuar të dhëna vetëm mbi notën mesatare hyrëse pasi programësh të vijim të vitit akademik nuk disponon notën mesatare dalje të studentëve. Kjo gjë u verifikua edhe në regjistrin e notave, që nuk është plotësuar pasi jemi ende Brenda vitit akademik. Dokumenti i notës mesatare hyrëse u vu në dispozicion nga specialistja e ASCAL. Cilësia e hyrjes dhe daljes të studentëve në MP menaxhim Bankar dhe Financiar kryesisht në notën mesatare të programit bachelor e cila varion nga 5.28 deri në 9.5. nota mesatare në hyrje rezultoi 6.8. Ky variacion ka të bëjë me faktin se nuk ka patur kritere strikte në vendosjen e një note mesatare dysheme poshtë të cilës të mos kishte të drejtë regjistrimi kandidati për MP.

Në aneksin e këtij raporti në **tabelën nr.16** jepen të dhëna më të detajuara

- Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare

NA

- Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

Bazuar në RVB, AU mundëson transferimin e studentëve në vite ndërmjetëse brenda ciklit të dytë, midis programeve të njëjta ose të ngjashme studimi, si brenda të njëjtë institucion apo institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë, private ose publike, vendase ose të huaja, si dhe lejon transferimin e studentëve të saj në shkollat e tjera të arsimit të lartë sipas procedurave të parashikuara në rregulloren mësimore dhe në rregulloren e regjistrimeve dhe transferimeve

Programi MP në 'Menaxhim Bankar dhe Financiar' krijon mundësi të mira transferimi në programet ekonomike të ngjashme të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë publik dhe privat në vend.

- Të dhëna për punësimin e studentëve. Numri total i të punësuarve (në përputhje/ jo në përputhje me diplomën)

Nga treguesit e marre në institucion për studentet e programit regjistrim i vitit akademik 2017-2018 rezultoi që rreth 80% e studentëve të këtij programi janë të punësuar si në përputhje me diplomën e programit Bachelor (rreth 65 %) ashtu edhe të punësuar në veprimtari jo ekonomike (15 %). Kjo argumentohet me mundësinë e zhvillimit të mësimin në orar të përshtatshëm pasdite gjatë ditëve të Enjte dhe të Premte si dhe në fundjavë.

Detajet janë në Tabelën 17

- Numri total të diplomuarve

NA

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Institucionit ju kërkuar dokumente shpesh lidhur me numrin e studentëve të regjistruar dhe notës mesatare, të cilat na u vunë në dispozicion dhe janë paraqitur në këtë raport.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p> <p>Kriteri 2 Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;</p> <p>Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit Europian të Gjuhëve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikatat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.</p>	<p>Nga verifikimi me zgjedhje që ne bëmë pranë sekretarisë mësimore konstatuam se në këtë program janë regjistruar studentët, të cilët zotërojnë diplomë bachelor me 180 kredite. Të gjithë studentët e regjistruar në këtë program rezultuan që plotësonin kriteret e përcaktuara nga AU, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p> <p>Në përputhje me ligjin e ri për arsimin e lartë studentëve të programeve “Master Profesional” nuk u kërkohet më mbrojtja e gjuhës së huaj, as si kriter në hyrje, as në dalje.</p> <p>Nga takimi me drejtues të institucionit u argumentua që arsyeja kryesore që ky program ofrohet me 60 kredite dhe afat 1 vit akademik është se ende ka interes më të madh nga aplikuesit për këtë program me këto karakteristika (pasi dalin më shpejt në tregun e punës).</p> <p>Mendojmë se institucioni duhet të synojë përthithjen e studentëve në këtë program me një cilësi më të lartë. Një ndër kriteret efikase do të ishte caktimi i një note mesatare në hyrje në këtë program në nivelin minimal 6, kriter ky që nuk është aktualisht</p>
Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikatat e punësimit.	
<p>Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>Studentëve të programit u ofrohet informacioni i nevojshëm nga institucioni lidhur për mundësitë e punësimit në përfundim të programit. Në AU funksionojnë dy zyra që japin informacion për mundësitë e punësimit dhe ofrojnë shërbimin e këshillimit.</p> <p>Mbështetur në RVB dhe në takimin e bërë në institucion me përgjegjëset e dy zyrave, rezultoi se Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve (ZKMS) është zyra e ngritur apostafat për të mbështetur studentët për orientimin dhe këshillimin gjatë gjithë cikleve të studimit. Zyra e Karrierës dhe Alumnit (ZKA) siguron lidhjet për studentët, komunitetin e gjerë universitar dhe botën e punës. Ajo mbështet në mënyrë aktive të diplomuarit në planet e tyre për karrierën dhe përshtatjen me tregun e punës. Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të programit dhe iu vihet në dispozicion “Udhëzuesi për Zhvillimin e Karrierës” gjatë zhvillimit të një viti akademik. Këto zyra parashikojnë një kalendar të aktiviteteve që lidhen me planifikimin e karrierës së studentëve. Në këtë Kalendar (që i përket vitit 2017 – 2018) paraqiten të dhëna me aktivitet e realizuara që konsistojnë në: leksione të hapura, tavolinë e rumbullakët, konkurs, vizitë studimore etj. Evidenca të tjera lidhur me aktivitetet i gjen në faqen e internetit (facebook, Instagram etj.). Çdo vit organizohet nga AU, Alumni - Open Days dhe Panairi i</p>

	<p>Karrierës që zhvillohet ose në ambientet e AU-së ose tek Hotel Tirana.</p> <p>Studenteve të programit që në momentin e aplikimit dhe regjistrimit informohen për statusin e akreditimit të programit dhe mundësi të njohjes së diplomës brenda dhe jashtë vendit.</p>
<p>Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p> <p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>GVJ konstatoi që ekzistonin statistika të plota mbi numrin e të regjistruarve, transferuarve dhe të larguarve nga programet e studimit të ciklit të dytë, si dhe të dhëna mbi ecurinë e studimeve të tyre, që nga pranimi deri në diplomim. Këto statistika merreshin nga zyra e Sekretarisë Mësimore.</p> <p>Bazuar në RVB këto të dhëna janë të regjistruara në Regjistrin Themeltar, në Regjistrin e Matrikullës, në Regjistrin e Rezultateve Akademike, në Regjistrin e Diplomave etj. Të dhënat janë edhe në variantin elektronik.</p> <p>Institucioni i analizon këto të dhëna për të nxjerrë konkluzione të vlefshme për procesin e vendimmarrjes.</p>
<p>Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>Nga takimet dhe të dhënat e marra nga ZKA pamë që bëheshin përpjekje për të siguruar të dhëna nëpërmjet kontakteve me studentët e diplomuar. Baza e të dhënave e ngritur në këtë drejtim megjithëse ka pasur përmirësim në aspektin sasior, ende nuk është e plotë, për shkaqe subjektive të studentëve të diplomuar që shpesh nuk japin të dhëna ose nuk përgjigjen në adresat që kanë depozituar në institucion gjatë zhvillimit të programit.</p> <p>Mbështetur në RVB rreth 80% e studentëve që ndjekin studimet janë të punësuar dhe ata ndjekin studimet për t'u kualifikuar më tej, për të siguruar një vend pune në administratën shtetërore ku diploma e studimeve Master është domosdoshmëri, për të qenë të suksesshëm në karrierën e tyre dhe për të ruajtur vendin e punës.</p>
<p>Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p> <p>Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p> <p>Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>Studentët e programit informohen që në momentin e regjistrimit dhe në vijimësi rreth treguesve sasior dhe cilësor të programit. Gjithashtu, informacioni ndodhet në faqen e internetit të universitetit, u dërgohet elektronikisht përmes adresave elektronike, si edhe shpallen në tabelat e njoftimeve (https://albanianuniversity.edu.al/sq/kreu/). Nga takimi me studentët morëm informacion se pas secilës detyrë apo provim, pedagogët zhvillojnë seanca sqaruese individuale ose në grup me studentët, për të sqaruar paqartësitë e mundshme në lidhje me vlerësimin e kryer. Rezultat e vlerësimeve diskutohen hapur brenda orës sqaruese për çdo provim nga titullarët dhe asistentët e lëndës.</p>

	Në raste kontestimesh departamenti organizon ballafaqimin student pedagog sipas rregullores së programit.
Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>ZKMS ndjek ecurinë e studimeve të studentit, që nga momenti i regjistrimit, deri në diplomimin e tij duke ofruar konsulencë për çështje akademike dhe studentore. Ky shërbim nuk zëvendëson këshillimin që jepet nga personeli akademik gjatë orëve të tutoriatit dhe këshillimit akademik. Nga takimi që patëm me studentët ata na informuan që ZKMS u ofron shërbim studentëve të programit duke ofruar informacion në lidhje me mundësi punësimi, apo aktivitete studentore që zhvillohen brenda ose jashtë vendit, duke ofruar njëkohësisht asistencë për kryerjen e aplikimeve apo këshillimin e nevojshëm. Kjo zyrë ka krijuar kontakte të shumta me kompani private dhe institucione shtetërore dhe bashkëpunon ngushtë jo vetëm në funksion të zhvillimit të praktikave profesionale të studentëve pranë këtyre institucioneve, por edhe në kuadër të punësimit të ardhshëm të studentëve në këto kompani e organizata.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>Studentëve të programit u ofrohet informacioni i mjaftueshëm që në fazën e aplikimit dhe gjatë zhvillimit të programit lidhur me procedurat, aspekte sasiore dhe cilësore të programit, mundësive të punësimit etj. Faza e këshillimit të tyre realizohet nga pedagogët që zhvillojnë mësim në këtë program por sidomos nga ZKMS. Të frytshme do të vlerësonim takimet në fokus grup me studentët.</p> <p>Rekomandime:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Institucioni duhet të ketë një database më të plote të dhënash lidhur me punësimet e studentëve të diplomuar të këtij programi.</i> - <i>Për të rritur cilësinë në hyrje të studentëve të këtij programi mendojmë se vendosja e një note mesatare "dyshe" poshtë të cilës të mos mund të regjistroheshin studentë në program do të rriste cilësinë e tyre</i> 	

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Terma reference: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e situara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

AU-ja që në vitet e para të veprimtarisë së saj është fokusuar edhe në komponentin e kërkimit shkencor si një nga komponentët e zhvillimit tregues i nivelit të institucionit. Gjatë vizitës në institucion dhe bazuar në RVB ne u njohëm me Strategjinë e Kërkimit Shkencor të Institucionit. Ajo përqendrohet kryesisht: në hartimin e strategjisë së kërkimit shkencor që miratohet nga Senati i AU; në realizimin e kërkimit shkencor bazë ose të aplikuar, studime dhe projekte për zhvillim, veprimtari të tjera krijuese sipas objektivave specifike të institucionit; në mbështetjen e veprimtarisë së stafit akademik, aftësimin dhe kualifikimin e tij; në procesin

akademik me programe, teori dhe praktika sipas Kartes se Bolonjes, duke krijuar një raport te drejtpeshuar dhe efektiv ndërmjetmësimdhënies e kërkimit shkencor; ne krijimin e shprehive dhe te metodave kërkimore shkencore me studentet, duke i aktivizuar ata deri edhe ne përfshirjen e tyre ne grupet studimore e projekte qe kane departamentet, fakultetet ose universiteti.

Nga informacioni që morëm doli se kjo strategji ishte rrjedhoje e një diskutimi me stafin dhe njësite bazë të institucionit. AU ka një pozicion te dedikuar përkërkimin shkencor, Zv/Rektorin përKërkimin Shkencor, i cili synon koordinimin e gjithë hallkave te kërkimit shkencor.

Zhvillimet në këtë drejtim i shohim në realizimin e disa produkteve dhe aktiviteteve shkencore në rang universiteti si:

- Ngritjen dhe botimin e konsoliduar të një periodiku tashme i njohur ne rajon është dhe revista “OPTIME”
- Çdo vit Fakulteti organizon KonferencënNdërkombëtare me teme “Problemet dhe Sfidat e Transformimit te Shoqerise Shqiptare drejt Standardeve te Bashkimit Europian”
- Departamenti realizon gjatë viti akademik aktivitete të shumta ekstra-kurrikulare me tema dhe të ftuar në shërbim të profileve të programeve që implementon.
- AU ka organizuar disa trajnime për zhvillimin profesional të personelit akademik në fushën e mësimdhënies. Trajnimet kanë pasur si objekt aftësimin për përdorimin e metodologjisë bashkëkohore të mësimdhënies, për hartimin e programeve lëndore, për specifikat e mësimdhënies me të rriturit, për njohjen me prirjet e zhvillimit të arsimit të lartë, përbashkëpunimin me shkollat dhe qendrat e zhvillimit të kërkimeve, për këshillimin e karrierës, vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm të arsimit të lartë, etj.
- AU ka ofruar një mobilitet për studentët he katër për stafin dhe kërkuesit si një nga mjetet më të suksesshme për avancimin e kërkimit shkencor dhe rritjen e standardit te produktit të kërkimit shkencor.
- Departamenti gjatë viteve akademike 2017-2018 dhe 2018-2019 ka realizuar aplikime në 7 projekte:
 - ✓ Spreading Excellence and Eidening Participation – part of H2020;
 - ✓ H2020-MSCA-NIGHT-2018;
 - ✓ International open innovation center applying Triple Helix Model: Academia, Government, and Industry;
 - ✓ MIGROUTE – H2020
 - ✓ FINLEAD – H2020
 - ✓ RESILIENCE – H2020
 - ✓ EACEA Programme "Europe for Citizens": Democratic engagement and participation.

Institucioni është pjese e projektit “GRADUA” (Erasmus + CBHE) ku nga departamenti i Shkencave Ekonomike janë te përfshirë dy pedagoge, Prof. Asoc. Manuela Mece dhe MSc. Aida Veliaj. GRADUA ka filluar te implementohet ne muajin tetor 2017 dhe do te vazhdoje deri ne muajin tetor te vitit 2020.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për kërkimin shkencor

Bazuar ne te dhënat e RVB te institucionit ky i fundit planifikon një sere aktiviteteve shkencore individuale apo te organizuara. Këtu përfshihen botime nga personeli akademik, pjesëmarrje ne projekte kërkimore, pjesëmarrje ne aktivitete shkencore brenda dhe jashtë institucionit si nga stafi ashtu edhe nga studentet.

Në aneksin e këtij raporti në **tabelën nr.18** jepen të dhëna më të detajuara

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar

Bazuar ne te dhënat e RVB te institucionit ky i fundit ka realizuar bashkëpunim kombëtar dhe ndërkombëtare nëpërmjet pjesëmarrjes ne këto aktivitete, ne realizimin e leksioneve me profesorë te huaj, trajnime te stafit nëpërmjet projekteve te bashkëpunimit etj.

Në aneksin e këtij raporti në **tabelën nr.19** jepen të dhëna më të detajuara

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.</p>	<p>Personeli akademik paraqet një herë në vit arritjet dhe angazhimet e tij akademike. Ata kanë kryer kërkime të cilat i kanë botuar në konferencat e organizuara nga vetë institucioni ose në konferenca të tjera jashtë vendit. Shumë prej tyre janë në autorë të teksteve shkollore universitare por edhe të shkollave të mesme. Personeli i ri akademik në kuadër të kualifikimeve të vazhdueshme kontribuon me publikimet apo kërkimet individuale.</p> <p><i>Pavarësisht përpjekjeve të bëra nga stafi akademik ne rekomandojmë që për rritjen e cilësisë së botimeve, lidhur kjo dhe me kuadrin ligjor dhe rregullativ aktual që kërkon publikime në revista me faktorë impakti mundësisht Scopus apo Thomson Reuters, që stafi të ketë një mbështetje nga ana financiare për kërkimin shkencor.</i></p>
Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.</p>	<p>AU nuk ofron programe studimi në gjuhë të huaj.</p> <p>Sipas RVB, pjese e personelit te AU jane angazhuar edhe ne mësimdhënie ne gjuhe te huaj ne universitete jashtë vendit</p>
Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe nga takimet e Bëra me stafin na u konfirmua se AU ka organizuar disa trajnime për zhvillimin profesional të personelit akademik në fushën e mësimdhënies. Personeli akademik i AU është mbështetur për kualifikime të mëtejshme brenda ose jashtë vendit. Në raste të caktuara pedagogët e brendshëm janë financuar nga Universiteti në realizimin e aktiviteteve të ndryshme shkencore.</p>
Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.	

Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;

Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;

Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.

Bazuar në të dhënat e përmbledhura në tabelën 19 dhe 20 mund të themi se AU disponon të dhënat për studimet shkencore, tekstet, monografitë, librat, artikujt apo kumtesat në konferenca si dhe të dhëna për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në programet e studimit Master. Pedagoget janë të përfshirë në disa projekte kërkimore-shkencore ku kanë aplikuar individualisht dhe në një program ndërkombëtar ku janë të angazhuar si pjesë e departamentit.

Konkluzionet e vlerësimit:

AU-ja ka pasur zhvillime pozitive lidhur me kërkimin shkencor gjatë 2 viteve të fundit. AU publikon revistën periodike "Optime" (dy herë në vit) e cila përmban artikuj shkencorë të pedagogëve të institucionit, por edhe shkrime të studiuesve jashtë AU. Gjithashtu, vihen re përpjekjet nga ana e stafit mësimor në përfshirjen e sa më shumë projekte kërkimore të institucionit me universitete apo institucione brenda dhe jashtë vendit. Gjithë veprimtaria shkencore e institucionit evidentohet nëpërmjet krijimit të një sistemi të dhënash. Bazuar në RVB, takimet e realizuara gjatë vizitës në institucion me drejtues të tij, zyrën e projekteve si dhe verifikimeve në vend të botimeve në revistat shkencore të botuara nga institucioni por edhe me gjerë, GVJ konkludon se gjate viteve te fundit institucioni ka bere relativisht progres ne fushën e kërkimit shkencor.

Rekomandim:

- Në mënyrë që stafi akademik të jetë i angazhuar në mënyrë të vazhdueshme në veprimtari kërkimore-shkencore duhet të ketë një mbështetje direkte nga institucioni nga ana financiare për kërkimin shkencor.
- Në funksion të kërkimit shkencor mendojmë se në kuadër edhe të strategjisë afatmesme të kërkimit shkencor të institucionit, ky i fundit duhet të synojë rritjen e numrit të studenteve të angazhuar në kërkimin shkencor pasi numri i tyre është i ulët dhe për më tepër nuk ka të përfshirë nga ky program si dhe pjesëmarrjen më të gjerë të tyre në veprimtari shkencore të organizuara nga vetë institucioni por edhe jashtë tij.

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Terma reference: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

AU-ja gjatë 2 viteve të fundit akademike (2017-2019) ka rritur nivelin e bashkëpunimit në nivel lokal dhe ndërkombëtar, gjë që kontribuon në marrjen e praktikave më bashkëkohore akademike në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies lidhur me personelin akademik dhe studentët. Bazuar në të dhënat e marra gjatë vizitës në institucion dhe RVB, institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi Universitete dhe organizata te huaja dhe shqiptare si: Universitetin Ningbo, Universitetin Powislanski, Universitetin Bujqësor të Tiranës, Kolegjin Qiriazi, Qendrën Shqiptare për Kërkime Ekonomike etj. Këto bashkëpunime i kanë shërbyer njohjes së eksperiencave të ndryshme në fushën e kërkimit dhe mësimin si njohjes së ndërsjellë të kulturave të vendeve respektive.

Më konkretisht këto bashkëpunime kanë synuar në:

- Konferenca të përbashkëta dhe programe kulturore;

- Shkëmbime të materialeve akademike, botimeve dhe dokumentacioneve të tjera;
- Shkëmbimin e pedagoqeve, kërkimeve shkencore, personelit administrativ dhe teknik;
- Shkëmbimin e studenteve;
- Projekte të përbashkëta kërkimore.

Institucioni është pjesë e projektit “GRADUA” (Erasmus + CBHE) ku nga departamenti i Shkencave Ekonomike janë të përfshirë dy pedagogë, Prof. Asoc. Manuela Mece dhe MSc. Aida Veliaj

Fakulteti ka arritur bashkëpunime me 24 institucione dhe biznese të ndryshme me të cilët ruan edhe kontakte të vlefshme në kuadër të studimit të tregut të punës, në kuadër të zhvillimit të praktikave mësimore të studentëve.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar

Institucioni gjatë viteve të fundit ka bashkëpunuar me njënumër universitetesh brenda dhe jashtë vendit në nivel individual (leksioneve të hapura nga profesor të huaj apo vendas të ftuar, si dhe organizimin e konferencave shkencore me bashkëpunim institucione homologe

- Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë

AU ka marrëveshje bashkëpunimi me 24 institucione financiare (banka, kompani sigurimi etj) si dhe me 8 universitete homologe nga të cilët 5 janë universitete ose kolegje universitare dhe 3 janë universitete jashtë vendit.

Në aneksin e këtij raporti në **tabelën nr.20** jepen të dhëna më të detajuara

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.	
<p>Kriteri 1 Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;</p> <p>Kriteri 2 Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>	<p>Studentët e programit MP në Menaxhim Bankar dhe Financiar që janë të punësuar, e zhvillojnë praktikën profesionale pranë ndërmarrjeve apo institucioneve ku punojnë. Pjesa tjetër e studentëve që nuk janë të angazhuar në marrëdhënie punësimi kanë mundësi që nëpërmjet bashkëpunimeve që AU-ja ka me bizneset apo institucionet të realizojnë praktikën mësimore në institucione të tilla si: Unioni Financiar Tirane sh.a., ACER, IDRA, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tirane.</p> <p>Një ndër praktikatat e njohura është realizimi i intershipeve të studentëve pranë këtyre kompanive që u jep mundësi të rritjes profesionale.</p> <p>Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi reciproke me këto 24 kompani duke siguruar angazhimin e studentëve në realizimin e kryerjes së praktikave por edhe në punësimin e tyre. Nga takimet me zyrën përgjegjëse si dhe takimin me studentët na u evidentua se çdo vit organizohet edhe Panairi i Karrierës ku ftohen biznese dhe kompani të shumta.</p>
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.	

<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>Nga takimi me antarë të stafit të Departamentit të Shkencave Ekonomike, në pamë praktikën e diskutimeve të stafit në fazën e hartimit të kurrikulës dhe programit. Mendimet e shfaqura në Departament janë objekt diskutimi dhe vendimi kolegjal. Departamenti i Shkencave Ekonomike si njësi që e mbulon këtë program studimi ka rregulloren e tij të veprimitarisë. Këto akte rregullative u japin përgjegjësinë stafit dhe njëkohësisht u shërbejnë bashkëpunimit mes antarëve të stafit</p>
--	--

Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.

<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Institucioni ka arritur gjatë viteve të fundit, disa marrëdhënie bashkëpunimi me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit, kompani që operojnë në tregun shqiptar me mundësi përfitimi për studentët e këtij programi.</p> <p>Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me 24 kompani të biznesit dhe institucione brenda vendit për tu mundësuar studentëve të MP menaxhim Bankar dhe Financiar që nuk janë aktualisht të punësuar për të realizuar praktikën profesionale pranë tyre. Kompanitë me të cilat Departamenti bashkëpunon në kuadër të praktikave mësimore përcaktojnë një udhëheqës të praktikës, i cili kontrollon dhe të informon mbi mbarëvajtjen e saj.</p> <p>Mbështetur në RVB, projekti/platforma GRADUA (website: http://graduaproject.com/) ne te cilin AU eshte pjese do të mundësoje forcimin dhe zgjerimin e lidhjeve me punëdhënësit dhe do të prodhojë statistika të ndryshme për përfitimet dhe ecurinë e marrëveshjeve.</p>
---	---

Konkluzionet e vlerësimit:

GVJ vlerëson se AU gjatë dy viteve të fundit ka ngritur bazat e bashkëpunimit me institucione vendase dhe të huaja për një periudhë afatmesme të suksesshme. Institucioni ka arritur që nëpërmjet marrëveshjeve me institucione dhe kompani të biznesit vendas të rrisë sigurinë e realizimit të praktikave profesionale të studentëve të programit MP menaxhim Bankar dhe Financiar pranë tyre. Kjo përbën edhe premisë që pas kryerjes së praktikës profesionale kompanitë të mund të punësojnë një numër të studentëve të këtij programi. Ky numër mund të jete edhe me i madh nisur nga numri i studenteve qe identifikojnë vete se ku duan ti ndjekin praktikat mësimore çdo vit.

Rekomandim:

Në funksion të plotësimit të standardit lidhur me bashkëpunimin kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun rekomandojmë që, institucioni të forcojë këtë bashkëpunim duke mbështetur Zyrën e Projekteve në hartimin dhe aplikimin e një numri më të madh projektesh me pjesëmarrjen më aktive të stafit akademik.




ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

I. ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KESHILLI I AKREDITIMIT NË VENDIMIN PËR AKREDITIMIN E PARË

- a) Rekomandimii pare: i plotësuar
- b) Rekomandimii dyte: i plotësuar.

II. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).

a. Pika të forta:

- 1) Realizimi i programit kryesisht nga PAE i kualifikuar me eksperience dhe me tituj akademik dhe grada shkencore.
- 2) Sigurimi i marrëveshjeve dhe krijimi i partneriteteve të ndryshme proaktive me biznese apo institucione që mundësojnë praktikat e studenteve, punësimin, potencial
- 3) Përdorimi i teksteve dhe programeve bashkëkohore të autorëve shqiptar dhe të huaj të përkthyer.
- 4) Vendndodhje strategjike dhe infrastrukturë e përshtatshme për zhvillimin e leksioneve/seminareve , praktikave etj.

b. Pika të dobëta:

- 1) Ngarkesë mësimore relativisht e lartë për një pjese te pedagogëve e lidhur kjo edhe me numrin e lëndëve që zhvillon një pedagog.
- 2) Interes i ulët i stafit akademik dhe studentëve në projekte dhe kërkim shkencor ndërkombëtar.
- 3) Numër i ulët i bashkëpunimeve kombëtare dhe ndërkombëtare nga zyra e projekteve.

c. Mundësitë:

- 1) Bashkëpunimi me institucionet dhe universitetet e tjera.
- 2) Përshtatja me e mire e programit ne funksion te tregut te punës me synim rritjen profesionale të studenteve
- 3) Vazhdueshmëria e trajnimit dhe forcimit të cilësisë së stafit si pedagogjik dhe shkencor duke konsoliduar pozicionin në tregun arsimor.
- 4) Forcimi i cilësisë në hyrje dhe dalje të studentëve.
- 5) Forcimi i lidhjeve me biznesin dhe pjesëmarrja e përfaqësuesve më të mirë të tij në auditorë.
- 6) Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe rajonal.

d. Pengesat:

- 1) Konkurrenca nga institucionet e tjera te arsimit te larte qe ofrojnë këtë program
- 2) Vonesat ne hartimin e gjithë kuadrit nënligjor dhe rregullativ
- 3) Mungesa e eksperiencës së stafit akademik në aplikime në projekte;

Rekomandimet:

1. Për një rritje cilësore të zhvillimit të programit të ulet numri i lëndëve që zhvillon një pedagog në jo me shumë se 3 të tilla të të njëjtës fushë, si dhe të mund të zbutet më shumë disproporcioni i ngarkesës mësimore mes pedagogëve
2. Megjithëse pranë AU shërbimi i sekretarisë ofron online për studentet marrjen e materialeve mësimore si dhe informacionin rreth vlerësimit të rezultateve të tyre, institucioni duhet të adoptojë një sistem me bashkëkohor për aksesin në kohë reale nga ana e studentëve. GVJ rekomandon përdorimin e sistemit RASH (Sistemi Kombëtar i Menaxhimit) për të mbështetur studentin në procesin mësimor në mënyrë që ata të kenë akses nga sistemi në kohë reale të azhurnohen materialet e hedhur nga pedagogu, leksione, materialet e shpesh audiovizive etj
3. GVJ rekomandon që për një rezultat me cilësor gjatë fazës së përmirësimit të programeve (përfshirë edhe këtë program) që në fazën e diskutimit në njësinë baze, Departament është e nevojshme marrja e një asistence apo opionence të jashtme nga akademike dhe eksperte në këtë fushë.
4. Në kuadër të hapësirave ligjore dhe nënligjore të ndryshimeve në kurrikul në vitet e ardhshme të mund të shihet mundësia e zëvendësimit të 2 deri 3 lendeve (të përmendura më lart) që janë kryesisht të nivelit teorike shkencor (ndofta për një program Master Shkencor) me lëndë të karakterit më profesional (te fushës së programit si Marketingun Bankar, Kreditin bankar, etj.) duke ju përgjigjur kështu edhe nivelit të mundshëm të studenteve që do të regjistrohen në të ardhmen në këtë program.
5. Mendojmë që bazuar në metodologjinë e përcaktimit të krediteve për lëndët e veçanta si dhe në mjaft eksperiencë të programeve në universitete të tjera numri i krediteve të përcaktuara për të dy lëndët me zgjedhje që janë 6 kredite të mund të ulet dhe për lende të detyrueshme si “Drejtimi i Portofolit” apo “Metoda Kërkimi të Avancuara” të rritet.
6. Institucioni duhet të ketë një database më të plotë të dhënash lidhur me punësimet e studentëve të diplomuar të këtij programi.
7. Për të rritur cilësinë në hyrje të studentëve të këtij programi mendojmë se vendosja e një note mesatare “dysHEME” poshtë të cilës të mos mund të regjistroheshin studentë në program do të rriste cilësinë e tyre
8. Në mënyrë që stafi akademik të jetë i angazhuar në mënyrë të vazhdueshme në veprimtari kërkimore-shkencore duhet të ketë një mbështetje direkte nga institucioni nga ana financiare për kërkimin shkencor.
9. Në funksion të kërkimit shkencor mendojmë se në kuadër edhe të strategjisë afatmesme të kërkimit shkencor të institucionit, ky i fundit duhet të synojë rritjen e numrit të studenteve të angazhuar në kërkimin shkencor pasi numri i tyre është i ulët dhe për më tepër nuk ka të përfshirë nga ky program si dhe pjesëmarrjen më të gjerë të tyre në veprimtari shkencore të organizuara nga vetë institucioni por edhe jashtë tij.
10. Në funksion të plotësimit të standardit lidhur me bashkëpunimin kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun rekomandojmë që, institucioni të forcojë këtë bashkëpunim duke mbështetur Zyrën e Projekteve në hartimin dhe aplikimin e një numri më të madh projektesh me pjesëmarrjen më aktive të stafit akademik.

SUMMARY ANALYSIS OF THE EXTERNAL EVALUATION REPORT USING SWOT METHOD (STRENGTHS, WEAKNESSES- OPPORTUNITIES AND, THREATS).

a. STRENGTH:



- 1) Program Realization mainly by qualified and experienced full academic staff (PAE) with academic titles and scientific degrees.
- 2) Providing agreements and creating different proactive partnerships with businesses or institutions that enable student practices and potential employment.
- 3) Use of contemporary texts and programs of Albanian and foreign authors.
- 4) Strategic location and suitable infrastructure for the development of lectures/seminars, mentoring, practices etc

b. WEAKNESSES:

- 1) Relatively high teaching load for the main part of academic staff this is related to the high number of courses that each of them develop.
- 2) Low interest of academic staff and students for participating in projects and international research.
- 3) Low number of national and international collaborations from the project office

c. OPPORTUNITIES:

- 1) Collaboration with other institutions and universities.
- 2) The adaption of the program in function of the labor market with the aim of professional growth of students
- 3) Continuing training and strengthen the staff quality such as pedagogical and scientific, by consolidating their position in the educational market.
- 4) Strengthening the quality of students at entrance and exit.
- 5) Strengthening business connection and the participation of its best representatives in auditors.
- 6) International and national collaboration.

d. THREATS:

- 1) Competition from other higher education institutions offering this similar program
- 2) Delays in the drafting of all legal and regulatory framework
- 3) Lack of experience of academic staff in project applications

Recommandation:

1. *To improve the quality of the program development, it is necessary to reduce the number of subjects that a lecturer develops, in not more than 3 of the same field, and to reduce the disproportion of the teaching load among lecturers.*
2. *Although at AU, the secretarial service provides students with online learning materials and information on evaluating their outcomes, the institution needs to adopt a more contemporary system for real-time access by students. The EEG (GVJ) recommends to using the RASH (National Management System) system to support the student in the learning process so that they have access to the system in real-time to be updated with materials cast by lecturers, lectures, additional audio visuals etc.*

3. *The EEG (GVJ) recommends that, for a qualitative outcome during the upgrading program phase (including this program), at the discussion stage at the base unit, the Department is required to receive external assistance or expertise from academics and experts in this area .*
4. *Based on the opportunity that the legal framework allow in having changes in the coming years of the curricula, it is possible to substitute 2 or 3 subjects (mentioned above) that are mainly of theoretical scientific level (perhaps for a Master's degree program) with subjects of a more professional character (in the field of program such as Banking Marketing, Banking Credit, etc.), thus responding to the possible level of students who will be enrolled in the future in this program.*
5. *We think that based on the methodology of determining the credits for the special subjects as well as the many experience of the programs at other universities, the number of credits set for both elective courses that can be 6 credits may decrease and for compulsory subjects such as "Portfolio Management" or "Advanced Search Method" to increase.*
6. *The institution should have a more complete database of employment opportunities for graduate students of this program.*
7. *To increase the quality of students' entrance to this program, we think that placing an average floor note below which students could not enroll in the program would increase their quality*
8. *In order for the academic staff to be continuously engaged in scientific research activities, there should be a direct financial support from the institution for scientific research.*
9. *In the function of scientific research we think that in the framework of the medium term research strategy of the institution, the latter should aim at increasing the number of students engaged in research because their number is low and moreover there is no included in this program and their broader participation in scientific activities organized by the institution itself but also outside it.*
10. *In order to meet the standard regarding national, international and public relations, we recommend that the institution strengthen this cooperation by supporting the Project Office in the design and implementation of a larger number of projects with the most active participation of academic staff.*

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm

Prof. Drini Salko



Prof. As Ermela Kripa

